

KOÇO BIHIKU

PROZA E MIGJENIT *

Në fund të viteve 30, por edhe disa kohë pas çlirimit, kur ende nuk ishin bërë të njohura «Novelat e Qytetit të Veriut» dhe ndonjë shkrim tjetër në prozë, që kishin mbetur dorëshkrim, për Migjenin u fol më tepër si poet. Kuptohet vetiu, se kjo nuk mund të mos çonte në një përfytyrim të njëanshëm dhe të pasaktë të krijimtarisë së shkrimtarit tonë të shquar realist. Talenti i Migjenit u shfaq në prozë po me atë madhësi, forcë krijuese dhe origjinalitet, që shkëlqeu edhe në poezi. Në të dyja këto fusha ai na la krijime të larta artistike dhe e tregoi veten si novator i vërtetë. Madje, «Novelat e Qytetit të Veriut», të cilat, sipas të dhënave, u shkruan në vitet 1936-1937, na shtyjnë të mendojmë se në periudhën e fundit Migjeni nisi t'i kushtohet më tepër prozës e cila me tiparet e reja ideore dhe artistike që fitoi, dëshmon për fillimin e një etape cilësorisht të re në veprën e tij.

Mbi veprën e Migjenit janë shkruar shumë artikuj, në të cilat një vend i mirë i kushtohet shkrimeve të tij në prozë¹. Por deri tashti ka munguar një trajtesë e plotë e kësaj pjese të trashëgimit të shkrimtarit, pa përmendur këtu se dhe në atë që është bërë për studimin e prozës së tij ka çështje dhe aspekte të pandriçuara ose të hetuara pjesërisht. Në punimin tonë bëhet përpjekje për një karakterizim sa më të plotë të prozës së Migjenit, të problematikës, të brendisë ideore, të gjinive dhe të stilit të skicave dhe të novelave të Migjenit.

* * *

Proza e Migjenit përfshin thuajse të gjithë problematikën e krijimtarisë së tij poetike. Dhe kjo është fare e natyrshme. Migjeni e filloi letërsinë duke hartuar në të njëjtën kohë vepra në të dyja këto gjini, prandaj ai rreth motivesh dhe idesh që gjejmë në poezitë, u pasqyrua edhe në skicat dhe në novelat e tij. Në të gjithë veprën e vet në prozë

¹) Ky punim u shkrua në vitin 1966 si kapitull i monografisë *Migjeni. Epoka dhe vepra*. Kur e përgatiti për ta botuar në revistën, SF, autori e shikoi duke bërë ndreqjet dhe azhurnimin e nevojshëm.

1) Për prozën e Migjenit shih: Dh.S. Shuteriqi, *Histori e letërsisë shqipe* për shkollat e mesme, Tiranë 1955, f. 263-269; V. Bala, *Letërsia shqipe e periudhës 1912-1939*, Tiranë, 1968, f. 93-116. po ai, *Milosh Gjergj Nikolla (Migjeni)*, Buletin për shkencat shoqërore, 1954, nr: 1, f. 55-76; R. Brahim, *Migjeni — flamur i letërsisë sonë luftarakë*, «Nëndori» 1958, nr. 8, f. 137-160; M. Gurakuqi, *Autorë dhe probleme të viteve 30*, Tiranë 1966, f. 36 dhe 62; R. Qosja, *Dialogje me shkrimtarët I*, Prishtinë 1968, f. 179-213, J. Ostreni, *Mendime mbi veprën e Migjenit*, «Nëndori» 1962, nr. 10 f. 37-51. I vetmi punim kushtuar posaçërisht prozës është ai i R. Kelmendit, *Proza e Migjenit*, në «Jeta e Re» 1955, f: 384-401.

Migjeni karakterizohet nga problematika e mprehtë sociale. Vend qendror në të zuri ajo që ishte kryesore në jetën e popullit: varfëria dhe skamja e madhe që e kishte kapulluar. Heronjtë e tij janë të varfërit, që ishin rrokur grykë për grykë me urinë që u kanosej dhe luftonin për t'i shpëtuar kamxhikut të saj të pamëshirshëm. Krahas kësaj, vëmëndjen e shkrimtarit e tërhoqën edhe shtresat e privilegjuara, mentaliteti, dëshirat dhe aspiratat e tyre, konfliktet që zhvillohen në ambientin e tyre mbi bazën e mosmarrëveshjeve të ngushta familjare.

Rruga e zhvillimit të Migjenit ishte rruga e pjekurisë së tij të shpejtë artistike. Në vitet e fundit ai forcohet plotësisht në pozitën e realizmit. Kjo përcaktoi kalimin e tij nga llojet e shkurtëra të prozës, të cilat përfaqësonin përshkrime statike portretesh dhe skenash të veçanta, në novelat, ku u përpoq të përftojë më thellë e më gjërë dukuritë dhe proceset e shoqërisë shqiptare. Në këto vepra Migjeni arriti të zbulojë fatin e heronjve në lidhje të ngushtë me rrethanat shoqërore të jetës së tyre dhe të depërtojë më thellë në botën e tyre të brendshme.

I

Në trashëgiminë në prozë të Migjenit një vend të mirë zë publicistika artistike. Janë ato skica satirike, pamflete dhe fejtone, të cilat kanë për temë çështje të rëndësishme shoqërore, letrare e filozofike të kohës, si çështjen e thelbit të njeriut e të qenjes së tij në përgjithësi, çështjen e luftës, çështjen e rolit të artit, të fesë dhe të moralit sundues etj.

Shkrimet e këtij lloji nuk ishin diçka e veçantë, karakteristike vetëm për Migjenin. Ato ishin tipike për një pjesë të mirë të letrarëve të rinj përparimtarë, si N. Bulka, P. Marko, A. Varfi etj., të cilët kishin dalë nga gjiri i popullit. Maniera, niveli i mjeshtërisë së tyre dhe llojet që lëronin, ndryshonin, por ata i bashkonte një qëllim: e vërteta e jetës së vendit. Ata kishin të njëjtët heronj dhe të njëjtët armiq. Pothuaj të gjithë këta shkrimtarë e nisën udhën e tyre në letërsi me shkrime të shkurtëra satirike, në të cilat zbuluan thelbin antipopullor dhe antipërparimtar të rendit shoqëror, stigmatizuan indiferentizmin dhe moskokëçarjen e aparatit shtetëror për hallet e popullit, treguan amullinë dhe gjendjen e mjerueshme në të cilën dergjej vendi, demaskuan rolin reaksionar të fesë, nxorën në pah alogizmin e jetës së kohës, goditën anakronizmin e zakoneve, koncepteve dhe të mentalitetit të vjetër.

*
* *

Duke lënë mënjanë «Të fala nga fshati», e cila, siç e tregon vetë përmbajtja, është një letër që autori ja dërgonte një shokut të ngushtë dhe si e tillë hyn në korrespondencën e paket të Migjenit, shkrimi i tij i parë që njohim është «Sokrat i vuejtun apo derr i kënaqun», botuar në maj të vitit 1935². Në këtë vepër Migjeni goditi hipokrizinë e njeriut, i cili dëshirat dhe synimet e tij të ulta i fsheh pas një pamje të jashtëm dinji-

2) Dh. S. Shuteriqi thotë, me sa i kujtohet, se Migjeni ka nisur të botojë për herë të parë në vitet 1933-1934 në organet e shqiptarëve të Rumanisë («Shqipëria e Re») (Shih: Dh. S. Shuteriqi, Migjeni me rastin e 10 vjetorit të vdekjes), «Literatura jonë», 1948, nr. 8, f. 2. Por me gjithë përpjekjet e bëra studjuesit nuk kanë zbuluar deri më sot asnjë shkrim të panjohur të Migjenit.

toze, por të rreme. Tema e prishjes së njeriut, e sundimit të hipokrizisë në shoqërinë e kohës njihej prej publicistikës përparimtare. N. Bulka kish botuar një varg fejtonesh, si «Zinxhiri i kalbur», «Karnaval», «Historia përsëritet» etj., në të cilat fshikulloi hipokrizinë dhe karakterin e rremë të moralit të kohës. Shkrime me përmbajtje demaskuese kundër falsitetit të parimeve morale botuan edhe autorë të tjerë.

Për nga problematika «Sokrat i vuejtun apo derr i kënaqun» i qëndron afër këtyre shkrimeve, por për nga mënyra e trajtimit ndryshon soje. Shkrimi i Migjenit priret më tepër nga pamfleti. Problemi i gjendjes tragjike të njeriut, i cili është shtërnguar të fshehë thelbin e vet, kundrohet këtu në plan historiko-filozofik. Që herët, thotë Migjeni, gjinia njerëzore u ndodh përpara alternativës ose të zgjedhë jetën plot përpjekje e shqetësime në emër të realizimit të idealeve të larta morale, ose të pranojë të vegjetojë si filistin, për të cilin mbi të gjitha qëndron kënaqja e trupit.

Sokrati, në përputhje me traditën e literaturës filozofike të kohës, e cila e pikturonte atë si martir që e vuri jetën në shërbim të së vërtetës, duke bërë për bindjet e veta sakrificën supreme, në veprën e Migjenit mishëron jetën kushtuar një qëllimi të lartë fisnik, kurse me derrin, tek i cili njerëzit shohin gjëllitjen banale dhe të kotë, Migjeni shprehu idenë e rrojtjes të kufizuar në përmbushjen vetëm të nevojave fizike dhe materiale. Objekti kryesor i sarkazmës së autorit është hipokrizia e njeriut, i cili preferoi kënaqjen e trupit, por e fsheh këtë me një maskë dinjitoze. «Derr! Vërtet se asht i lakmueshëm derrin, por, sadokudo do të ruhet dinjiteti njerzuer përpara botës edhe se mikroskopike në pikëpamje të tolerancës morale», — thotë Migjeni, prandaj njeriu, «muer ftyrën e Sokratit të vuejtun — por vetëm ftyrën — e pjesën e mbrame ja muer krejt derrit. De jure u ba Sokrat — e de facto ishte derr».

Megjithëse Migjeni pati një kuptim me të thellë të çështjes që trajtoi, prap natyrën njerëzore ai e pa sikurse letrarët e tjerë përparimtarë, në plan abstrakt. Njeriu, që mori ftyrën fisnike të Sokratit, duke mbetur në thelb siç kishte qenë më parë, egoist dhe lakmitar, është njeriu abstrakt, i shkëputur nga lidhjet e tij historike reale.

Në analizën e pamfletit «Sokrat i vuejtun apo derr i kënaqun», duhet të kemi parasysh se demaskimi i aspiratës mikroborgjeze për një jetë të zhytur në kënaqësira të vogla dhe lidhur me këtë i bigotizmit, është një temë e njohur në letërsinë përparimtare të shekullit XX. Për këtë kishin folur një varg shkrimtarësh. «Sokrat i vuejtun apo derr'i kënaqun» na kujton më tepër shkrimet e njohura të Gorkit mbi filistinizmin («Shënime mbi filistinizmin», «Shkatërrimi i personalitetit», «Mbi djallin» etj.). Me përrallën «Derri prej farfori» të Gorkit gjejmë afërsi jo vetëm në ide, por edhe në figura. «Derri prej farfori», si derrin në pamfletin e Migjenit, është mishërim i rrojtjes banale, i jetës së ngopur dhe të qetë mikroborgjeze. Nuk përjashtohet hipoteza që shkrimtari ynë i ri të jetë frymëzuar për pamfletin e vet nga artikujt e njohur të Gorkit dhe, në mënyrë të veçantë, nga përralla «Derri prej farfori». Por në këtë mes përmbi të gjitha na intereson çështja, në se përveç këtij burimi letrar kur shkroi «Sokrat i vuejtun apo derr i kënaqun», a ka patur Migjeni ndonjë impuls edhe nga jeta shqiptare? Shqyrtimi i kujdesshëm i brendisë së pamfletit dhe i problemeve më të rëndësishme, që shqetësonin shoqërinë shqiptare, na çon në konkluzionin se në hartimin e veprës, përveç ndikimit nga leximet e viteve në seminar, Migjeni do të ketë pasur shtytje edhe nga jeta shqiptare.

Për nga problematika afër «Sokrat i vuejtun apo derr i kënaqun», qëndrojnë «Tragjedi apo komedi» (1934) dhe «Idhujt pa krena» (1936). Në këto shkrime Migjeni shtron problemin e ekzistencës së vështirë, plot kontradikta të njeriut në përgjithësi, ose më mirë të themi, të njerëzimit. Tema e pamfletit «Tragjedi apo komedi» është fati tragjik i fisit njerëzor, që është dënuar të bëhet lodër e koncepteve morale, filozofike, shoqërore, d.m.th. e «idhujve», që krijoi vetë. Në themel të këtij shkrimi qëndron ideja se koncepti i së mirës dhe i së keqes, i së dobishmes dhe i së dëmshmes, të cilat njerëzit vijojnë ende t'i marrin parasysht në veprimtarinë e tyre, janë krijesa të vetë mendjes njerëzore. «E Mira, e Keqja, Perëndia prej territ nëpër njeriun erdhën në dritë, edhe nëpër njeriun kanë me u zhdukë në terr — mbrapa tyre ka me mbetë një nështypje e pacaktueme, e cila ka me u fundosë në gjinin e jetës me harrësë të plotë», — shkruan Migjeni. Por gjer sa njerëzimi të çlirohet prej tyre është ende larg e ndërkaq ato po i sjellin atij dëm të madh. Të krijuara dikur prej njeriut, përfytyrimet e konceptet e ndryshme dolen më vonë kundrejt tij si forcë e pavarur e jashtme dhe arritën ta bëjnë atë skllav, ta pengojnë të rrojë i lirë dhe të ndërtojë jetën e vet mbi bazat e arësyes. Këtë ide Migjeni e shprehu nëpërmjet krahasimit të njeriut me kitarën, nga telat e së cilës dalin tinguj nga më të ndryshëm kur nëpër to kalon një dorë. «Gjini njerzuer asht një kitarë e gjallë mbi të cilën një dorë pasionale përfiton të dridhunat e telave ndër melodina, tragjike a komike?» — thotë autori. Dhe ndër konceptet e paragjykimet ato që e bënë në mënyrë të veçantë shpirtin e njeriut objekt të lakmive të tyre qenë paragjykimet fetare. «Gjini njerzuer asht një kitarë e gjallë nëpër të cilën Shejti dhe Katili arrijtën shprehjen e tragjedisë apo komedisë së vet».

Se sa i varur ishte njeriu prej koncepteve e paragjykimeve që krijoi vetë kjo u duk qartë sipas Migjenit sidomos në vitet 30, në prakun e luftës së dytë botërore, kur revanshistët gjermanë dhe fashistët italianë, nga një anë, dhe shtetet e mëdha kapitaliste të Evropës perëndimore, Anglia dhe Franca, nga ana tjetër, po gatiteshin ethshëm për kasaphanën e madhe të luftës. Duke propaganduar shovinizmin, racizmin dhe teori të ndryshme reaksionare, ideologët dhe publicistët borgjezë shfrytëzuan për këtë qëllim ndikimin e koncepteve të vjetra, robër të të cilëve ishin njerëzit. «Tash, gjini njerzuer - shkruan Migjeni, - asht skena ku e Mira, e Keqja, Perëndia çfaqin dramë mnije e dashunie, përbuzje e simpatije, dëshirash dhe apathije, adhurimesh dhe mallkimesh... e tue çfaqë dramën luftarake me një shkathtësi artistike dhe me një madhështi teatrale ngulin thika të mprehta, lëshojnë shigjeta të helmueme e vjellin plumbin e vluem ndër gji njerzore dhe bërtasin me brimë ngallnjyese. Lufta e fitueme - tragjedia - përfundohet me një «Te Deum» majestoso, me një «Te Deum laudamus» te qelbsuem. Këjo «Te Deum» asht uvertura e një operës komike, që quhet pagja...». Me figura të forta satirike Migjeni tallet me psikozën e luftës, që kishte mbushur atmosferën e Evropës në këtë periudhë, me nxitjen e paragjykimeve nacionaliste, raciste etj. prej shtypit reaksionar borgjez dhe fashist, i cili loste një rol të rëndësishëm në mashtrimin e njerëzve dhe të popujve. Me zemërim të papërmbajtur Migjeni çjerr demagogjinë e drejtuesve të shteteve kapitaliste, të cilët mjetin e shëmtuar nëpërmjet së cilës duan të arrijnë qëllimet e tyre egoiste — luftën — e veshin me aureolën e diçkaje të rëndësishme, e për më tepër, të shenjtë.

Duke rrëfyer për të gjitha këto, Migjeni vë theksin në gjendjen tra-

gjike të njeriut, të cilin e krahason me Kanion, protagonistin e operës «Paliçi». Ashtu si heroi i Leonkavalos, i cili është i detyruar të qeshë e të argëtojë të tjerët, duke fshehur dhëmbjen e madhe, që i çjerr shpirtin, edhe njeriut s'i mbetet tjetër veç të qeshë për gjendjen e tij tragjike, ku ndodhet, të qeshë kur është me të vërtetë për të qarë. Me të qeshurit, ai duhet të fshehë dëshpërimin për ekzistencën e vet tragjike.

Skica «Idhujt pa krena» është e lidhur më tepër me jetën shqiptare. Në të rrihet një nga problemet aktuale të kohës: shkatërimi i traditave dhe i formave prapanike, të jetës dhe ngritja në vend të tyre e formave dhe traditave të reja.

Në vitet 30 në rrethet intelektuale diskutohej çështja, se kishte ardhur koha që format e organizimit të jetës shoqërore, të trashëguar prej kohës së sundimit turk, të zëvendësoheshin me tradita dhe zakone të reja. Nevoja e këtyre ndryshimeve kuptohej dhe pranohej si prej rretheve përparimtare e revolucionare ashtu dhe prej intelektualëve borgjezë, por ndërsa të parët e shikonin këtë problem vetëm si një pjesë të transformimeve më të thella dhe më të rëndësishme, që duhet të kryheshin në strukturën politike dhe shoqërore të vendit, të rinjtë intelektualë, që rridhnin nga familjet e pasura e konsideronin si operacionin e vetëm e të fundit, që duhet të bëhej në organizmin e shoqërisë shqiptare.

Pikëpamjen e vet lidhur me këtë problem Migjeni e parashtroi në «Idhujt pa krena». Si njeri i gatitur me frymë revolucionare, ai ishte armik i çdo gjëje të vjetër, anakronike, që pengonte ecjen përpara, drejt formave më të larta e më të mira të organizimit të jetës shoqërore. Idënë e vet se traditat dhe institucionet e vjetra janë caktuar të zhduken dhe se nuk ka forcë që t'i shpëtojë ato, Migjeni e shprehu përmes figurës origjinale të «idhujve pa krena», të këtyre «dëshmorëve të shëmtuem të një jete së perndueme», të cilët sa më tepër të qëndrojnë në mes të njerëzve, aq më shumë dëm do të bëjnë. Shkrimtari i krahason ato me kufoma dhe, si të tilla, thotë ai, këto duhen zhdukur sa më parë. «Çdo gja që s'ka krye asht kufomë, e kufoma s'e ka vendin në mes të gjallëve. Kufoma duhet varrosë. Përndryshe e përlyemja me 'të ka për të qënë katastrofale. E katastrofa asht katastrofë: Nuk kursen. Zhduk kombe!» — shkruan autori. Këtu Migjeni hap kllapat dhe prej shqyrtimit në formë të përgjithshme të problemit hidhet në terrenin konkret. Për të treguar se mbajtja në këmbë e institucioneve të vjetëruara politike dhe shoqërore është vdekjeprurëse, ai merr si shëmbëll historinë e kombit tonë. Shkaku i fatit të vështirë të popullit shqiptar nëpër shekuj, sipas tij, kanë qënë format anakronike të jetës shoqërore e familjare, traditat prapanike, kanë qënë «idhujt pa krena». Dhe në qoftë se ai s'u zhduk, arsyeja, sipas Migjenit, duhet kërkuar në faktin se edhe tek popujt e tjerë të Ballkanit format institucionet e vjetra shoqërore u mbajtën gjallë për një kohë të gjatë.

Pamfletin «Idhujt pa krena» e përshkon bindja, se së shpejti do të shfaqen ide, tradita dhe forma të organizimit të jetës që do të shprehin nevojat dhe kërkesat e reja të kohës. Po për këtë duhet të lindë një njeri i ri, dhe sa më parë të dalë ky, të cilit do t'i ngarkohet barra të ndërtojë «idhujt e ri», aq më shpejt do të zhduken «idhujt pa krena».

Në arësytimet rreth «idhujve pa krena» dhe «idhujve të ri», nuk mund të mos bjerë në sy një imtësi jo pa kuptim. Për «idhujt e vjetër» që po perëndojnë, për «bukurinë e tyre ceremoniale» dëshpërohen «njerëzit, që jetojnë në mes tyre», thotë autori, kurse «idhujt e ri... kanë për t'u adhurue nga turmat». Në këtë dallim të shkoqur nga një anë të

njerëzve të mësuar me idhujt e vjetër dhe në anë tjetër të turmave ësh-të shprehur hapur koncepti i Migjenit mbi thelbin e «idhujve të rinj». «Idhujt e ardhshëm do të shprehin jo vetëm nevojat e reja të kohës, por edhe aspiratat e masave, ato do të jenë ide e tradita të mbështetur mbi interesat e nevojat e kolektivit.

Nga sa thamë më sipër, është e vështirë të pranohet teza sipas së cilës në «Idhujt pa krena» Migjeni shtroi problemin e futjes në masat të teorisë revolucionare marksiste-leniniste³. Kuptohet vetiu, se shkas për një interpretim të tillë ka dhenë karakteri i errët i shkrimit. Rruga më e sigurtë për të zbuluar idenë e pamfletit «Idhujt pa krena» është ajo që u ndoq më sipër d.m.th. të nisemi nga rrethanat shoqërore në të cilat ajo u shkrua, nga problemet që preokuponin mendimin shoqëror përparimtar të kohës. Problemi i ndryshimeve që duheshin bërë në jetën shoqërore e familjare në përputhje me vetë kërkesat e kohës, i rrugëve praktike që duheshin ndjekur në këtë çështje, problemi se cila tradita duheshin ruajtur dhe cila duheshin flakur si regresive, çfarë formash të reja të organizimit të jetës duheshin futur etj., këto ishin probleme që u rrahën gjerësisht në faqet e shtypit të kohës dhe preokupuan letrarët përparimtarë. «Që qytetërimi është i domosdoshëm, i pandalueshëm, asnjëri s'e kundërshton. Që mentaliteti duhet ndërruar dhe që mënyra e jetesës duhet ndryshuar, këtë e dimë të gjithë, — shkruante aso kohe N. Bulka. — Por ka gjëra që s'i dimë të gjithë. Për shembëll: «ç'quhet qytetërim?» Cilat zakone duhet të shqelmojmë, cilat duhet të mbajmë? Ç'duhet të vjedhim, ç'duhet t'i përbuzim perëndimit të qytetëruar?

Shkrimtarët e rinj përparimtarë bënë një luftë të madhe kundër traditave dhe zakoneve të vjetra që pengonin emancipimin shpirtëror të masave të popullit. «Idhujt pa krena» janë traditat dhe institucionet prapanike, të cilat i përmbysi «një tufan i tmershëm». «Një tufan i tmershëm — shkruante me ironi Migjeni — i shembi idhujt. Disa i bani pluhun e disa i la pa krena». Në figurën e tufanit shkrimtari paraqiti procesin e pandalshëm të përparimit shoqëror e jo marksizëm-leninizmin. Të pohosh se me «Idhujt e rinj» Migjeni kishte parasysht domosdoshmërinë e teorisë revolucionare, do të thotë të nisesht nga konkluzione paraprake në analizën e brendisë së veprës.

Në fejturin «Urime për 1937» Migjeni me një ironi të hollë aludon për gjendjen e rëndë të kohës. Kudo rreth vetes ai sheh vuajtje dhe privacione. «Së pari, t'uroj, shok i dashtun... gjumin e ambël! — të mos dëgjosh si afër teje gërset dhëmballa për dhëmballë nga të ftohtit. Se atëhere duhet të pyesish: mos dhëmballë, pse ndeshe për dhëmballë dhe gërset aq? E gjuha në vend të dhëmballës përgjigjet: pse asht ftohtë, zotni, e kur asht ftohtë, zotni, u hyn dreqi trupit, muskulave, nervave, zotni, dhe q'ashtu gërset dhëmballa për dhëmballë, zotni. Asht tepër banale të thomi, se mungon veshja dhe mbathja dhe zjarrmi prandej gjumin e ambël, shok i dashtun».

«Urime për 1937» ka rëndësi se problemet që rrahu Migjeni u bënë më vonë temat kryesore të krijimeve të tij artistike. Rrojtja e vështirë, plot brenga dhe halle e popullit për të cilën në këtë vepër flitet në mënyrë të tërthortë, u bënë brendia e skicave «Moll'e ndalueme». «Bukuria që vret», «Legjenda e misrit» dhe e tregimit «Bukën tonë të për-

3) J. Ostreni, *Mendime mbi veprat e Migjenit*, «Nëndori» 1961, nr. 10 f: 47:

ditëshme falna sot... Në skicën «Urime për 1937», pasi karakterizon me disa fjalë gjendjen e zyrtë të vendit Migjeni hidhet me sarkazmën e fortë që e shquan, kundër frymës gjoja optimiste të artit që orvatej të krijonte në masat idenë se në përgjithësi gjithshka ishte në rregull. «Së dyti, mbas gjumit të ambël t'uroj — ç'asht dhe e natyrëshme — të jesh i gëzuem, gjithmon'i gëzuem. Nga gëzimi i madh, në sentimentalizëm, të puthish drrasat e dhomës e shtyllat, si bani Greta Garbo në filmin «Mbbrethesha Kristina», kur shijoi dashunin shtazore (desha të them hyjnore, por njësoj asht). Aq i gëzuem sa që bota të ta kenë zili dhe të thonë: Oh sa i lumtun asht! Të jesh i gëzuem, edhe pse n'anë tjetër zemra të pëlset, si paljaços». Prap këtu del figura e paljaços nga opera e njohur e Leonkavalos, e cila këtu mishëron njeriun që është shtërnguar të bëjë të kundërtën e asaj që ndjen në shpirt.

Do të ishte gabim të mendohej se Migjeni, kur fliste për optimizmin e shtjerë, kishte parasysh vetëm filmat komercialë borgjezë, që mbushnin në atë kohë kinematë e vendit. Megjithëse nuk përmend emra dhe tituj, por kuadri kthjellohet po të kuptojmë se një pjesë e shtypit të viteve 30, sidomos ai që përkrahte politikën e regjimit monarkist, bënte çmos të krijonte përshtypjen se në Shqipëri jeta në përgjithësi ishte e gëzuar, se përveç disa gjërave të vogla, që mund të rregulloheshin pa vështirësi, çdo gjë shkonte si jo më mirë. Pra, duke goditur optimizmin fals të filmave të huaj, Migjeni në mënyrë të tërthortë stigmatizonte shtypin zyrtar dhe gjysmëzyrtar, që përpiquej të vinte në gjumë ndërgjegjen e shqetësuar të njerëzve.

Problemi i vendit të artit dhe i rolit të tij në jetën e shoqërisë e interesoi Migjenin qysh në të ri, kur s'kishte nisur ende t'i kushtohej veprimtarisë letrare. Nga të dhënat biografike del se që kur ish në seminar ai interesohet për vepra ku shqyrtohej çështja e thelbit dhe e funksionit shoqëror të artit. Ky interesim për problemet teorike të artit koïncidon me kohën, kur ai lexon me etje të madhe përfaqësuesit e mëdhenj të letërsisë realiste botërore, Tolstoin, Dostojevskin, Gorkin, etj. Migjeni ishte për një art militant që merr anën e të shtypurve dhe të të munduarve, një art që lufton për një rend më të drejtë shoqëror. Që këtej vinte ai qëndrim negativ kundrejt artit, që justifikonte shfrytëzimin e njeriut prej njeriut ose përpiquej t'i mbante njerëzit larg çështjeve kryesore të jetës së tyre.

Demaskimi i parullës së «artit të kulluar», të apoliticizmit dhe individualizmit është tema e pamfletëve «Novelë mbi krizë» (1935), «Programi i një reviste» (1936), dhe «Vetëvrasja e trumcakut» (1936).

«Novelë mbi krizë» është një kamxhik i fortë që i hiqet artit për art që mbron rendin e klasave shfrytëzuese. Migjeni mendon se parrulla e artit të kulluar, të pavarur nga jeta, është një perde pas së cilës letrarët dhe publicistët borgjezë shkojnë dhe e vënë artin e tyre në shërbim të hapur të privilegjeve të klasave të pasura. Këtë ide ai e zbuloi nëpërmjet rrëfimit konvencional fantastik. «Për një kohë të shkurtë shndrroi faqen shteti. Arti i frymëzuem dhe i punuem mbas recetave të Parisë, shndrroi shtetin në një muzeum artistik. Ishte triumf i recetës. Ose triumf i artit me qëllim! E qëllimi u mrrinte dalngadalë, por me siguri. Kur shndrroi faqen shteti zunë të shndrrojnë trajtat dhe shpirti i nënshtetasve. Shpirti, dikur pëllumb, ishte bam skyfer, tash u ba prap pëllumb».

Shkrimtarët borgjezë çirren se arti i tyre është i çinteresuar, rron për vete, se ai nuk shikon as interesat e masave të varfëra, që i nën-

shtrohen shfrytëzimit dhe shtypjes sociale, edhe as ato të klasave të pasura. Këtë mashtrim Migjeni e stigmatizon me sarkazëm dërrmuese. Arti i klasave sunduese nuk është i pavarur nga forcat, që e kanë rritur dhe e mbajnë; ai ekziston që të mbrojë mirëqënjen dhe kapitalet e tyre. «... Lypsat — shkruan Migjeni — nuk u kërcënohen të pasunve, e këta pa frigë, fryhen si bibonat me thalba arrash dhe shkëlqejnë si lustritë të këpucës. Fryhen të pasurit, barku i tyre lodërtinë, por me pel-sitë jo!».

Në fund autori shpreh idenë se mashtrimi dinak, viktimë e të cilit janë masat popullore, nuk e ka të gjatë. Do të qëndrojë sa do të qëndrojë perdja e gënjeshtërs, me të cilën u kanë zënë sytë njerëzve artistët dhe letrarët borgjezë, por së fundi, do të grisët dhe e vërteta do të dalë në shesh. Pa dyshim, se kjo s'do të ngjasë shpejt. Sa të çpërgjumen masat duhet një farë kohe, gjatë së cilës do të ketë sakrifica dhe humbje të dhimbshme. Lëngimi i lypsit të ri, që theu të gjitha statujat, flet për procesin e vështirë të çlirimit shpirtëror të të shtypurve.

Në këtë vepër demaskimi i teorisë së artit të kulluar, i «artit për art» realizohet me anë të konvencionit. Vepra thuret si rrefim për shtetin X, paria e të cilit përpiket të përdorë artin për sigurinë dhe rehatinë e klasave të pasura. Me gjithë karakterin konvencional «Novelë mbi krizë» e arrin qëllimin e vet: ajo çjerrë pa mëshirë maskën e mbrojtësve të «artit për art».

Në fejtënin «Programi i një reviste» (1936) në një formë origjinale përqeshen letrarët borgjezë, që çirren për pavarësinë e artit nga politika dhe shoqëria. Efektin komik Migjeni e arrin duke përshkruar situatën absurde e qesharake, në të cilën u ndodhën redaktorët e një reviste, kur panë se organi i tyre apolitik, të cilin ata e mendonin si diçka shumë të nevojshme dhe të rëndësishme për shoqërinë, u prit me indiferentizëm të plotë nga njerëzit. Përshkrimi me dy-tri viza të goditura i qëndrimit të udhëtarëve, të cilët e shohin me mospërfillje njoftimin mbi daljen e revistës, zbulon se sa larg ishte ajo nga jeta dhe brengat e mëdha të popullit. Më në fund, kur mbeten pa të holla, redaktorët e revistës ideale, që nuk merrej me politikë, vendosin të kërkojnë subvencion nga shteti. Me këtë frazë Migjeni qëllon drejtë aty ku donte: në hipokrizinë e parrullës së apoliticizmit, pas së cilës fshiheshin publicistët dhe shkrimtarët reaksionarë, këta shërbëtorë të rendit çifligaroborgjez.

Disa shkrime të Migjenit nuk japin mundësi të nxjerrësh një kupim të vetëm dhe të qartë. Aluzionet e largëta, gjuha e vështirë bëjnë që ato të zbërthehen me zor dhe në mënyrë të përafërt. Një ndër këto është «Vetëvrasja e trumcakut», botuar më 1936. Ka shumë të ngjarë që shkasin për këtë vepër autorit ja kanë dhënë shkrimet e bujshme pseudoromantike me të cilat ishte mbushur shtypi zyrtar i kohës. Për këto shkrime është karakteristike një pakënaqësi e papërcaktuar nga jeta, që më tepër se një ndjenjë e vërtetë, e shkaktuar nga dizarmonia që vishesh re përreth, ishte diçka e shtirur, fryt i leximeve të ndryshme ose imitim i poetëve romantikë të shekullit të kaluar. Individitë i goditur nga një melankoli e zyrtë, sepse gjithshka që shihte nuk e kënaqte shpirtin e tij të zgjedhur, ishte një nga temat më të dashura të këtyre autorëve. Kjo na lejon të shikojmë në «Vetëvrasjen e trumcakut» një parodi të hollë kundër individualizmit dhe pesimizmit të shplarë të shkrimeve pseudoromantike. Duke rrëfyer historinë e trumcakut melankolik, që rron diku, ku «në vend të barit bijnë qimet e dërrit e në vend

të pemëve brenat të një shtazës parahistorike», Migjeni tallet, me sa duket, jo vetëm me arësytimet pesimiste e pseudofilozofike të këtyre autorëve, por edhe me iracionalizmin dhe kapërcimet e pakuptueshme e të pamotivuara me të cilat ishin mbushur krijimet e tyre. Ky motiv vjen duke u forcuar dhe në fund rritet deri në demaskimin e çdo lloj ekuilibristike. «Ç'ka janë këto kapërcime logjike» ka me bërtitë ndokush. Po, lexuesi i dashtun e jo i cekët. Po! — A pak po kemi kapërcime logjike, morale dhe dogmatike në botën tonë reale? Pse po zemrohe dhe po më don me më gjykue për disa kapërcime logjike askuj dam-sjellse?» Migjeni ve kështu në lojë në përgjithësi publicistët borgjezë e klerikalë katolikë, të cilët mundoheshin t'u prishnin mëndjen njerëzve me arësytimet e tyre të ngatërruara sofistike.

Jo më pak e errët është edhe skica «Ose... ose...». Me sa duket, Migjeni rrahu në këtë vepër problemin e luftës dhe të qëndrimit të njerëzimit ndaj saj. «Ose... ose» pa dritën në vitin 1933 d.m.th. në piskun e fushatës së madhe propagandistike pro-luftës që kishte shpërthyer në shtetet fashiste, Gjermani dhe Itali. Me këtë propagandë gazetave dhe revistat fashiste synonin të pregatisnin opinionin publik botëror për veprimet agresive që do të ndërmyrrnin për së shpejti shtetet e tyre. Me lajmet që flisnin për përgatitjet për luftë të shteteve kryesore të Evropës, ishin mbushur edhe faqet e gazetave të vendit. Ka të gjasë që Migjeni e shkroi këtë skicë nën përshtypjet e këtyre lajmeve. Demagogjia reaksionare e shteteve fashiste, synimet grabitqare që ata ndiqnin, kasaphana e llahtarshme që po pregatitej për popujt e Evropës, i dukeshin Migjenit një krim i pafalshëm kundër njerëzimit. Për Migjenin, lufta ishte një «valle» shumë e rezikshme, që luhej me fatin e njerëzimit. Megjithëse njerëzit nuk e duan luftën («jehona e këtij lajmi dërmoi themelet e ekzistencës njerëzore», thotë autori) prap ata nuk e kanë të qartë se kujt i shërben lufta.

Migjenin e shqetësonte çështja se deri kur popujt do të lejojnë që të mashtrohen prej qarqeve drejtuese dhe ideologëve reaksionarë. Në skicën «Ose... ose» buthton ideja e çpërgjumjes së masave. «U mblodhën taborret dhe u vunë në lëvizje. U lëvizëshin me entuziazëm... Po ku... : ku asht armiku? Si nuk ja pamë ende gjurmat — u ngritshin pyetjet në taborret. Tashti entuziazmi u ftof, u ftof dhe u ba akull. Armët u sullën për tokë kundra thneglave, të cilat në këtë rast ishin të pafajshme. Tek atëhere prisit u kujtuen... U sullën përballë taborreve e në ballë të secilit ushtar lexuen një fjali tragjike, në ballë rrudhash të shëmtueme. Njerzia kundër njerëzisë, do me thanë lufta në vetvete, me një fjalë tjetër revolucion!» Shkrimtari mendon se njerëzimi mund të shpëtonte nga kasaphana e luftës drejt së cilës po e shtynin drejtuesit, në qoftëse do të shkundte nga vetja pasivitetin e do të vepronte praktikisht e tij si Don Kishoti. Don Kishoti këtu mishëron njeriun e aksionit, i cili nuk humbet në arësytime të pafrytshme, që topitin vullnetin, siç ngjet me Hamletin. Vërtetë veprimet e Don Kishotit janë aventura, por thotë autori, aventura të domosdoshme. Po që se vazhdon rolin e Hamletit, njerëzimi do të mbetet gjithnjë viktimë e mashtrimeve të klasave drejtuese.

Fraza «Njerëzia kundër njerëzisë, do me thanë lufta në vetvete, me një fjalë tjetër revolucion!» ka dhënë shkas për ta kqyrur «Ose... ose» si vepër në të cilën Migjeni ka shprehur mendimin se «lëvizja e masave punonjëse po zgjerohet gjithënjë e më shumë, se ato po bëhen një forcë

e vërtetë për të përmbysur regjimet shfrytëzuese»⁴. Ky është një konkluzion me parti pris dhe nuk buron nga analiza objektive e veprës. Për t'u bindur për këtë mjafton të shikojmë se si e ka thurur atë shkrimtari. «Ose... ose» ka një ndërtim të vetin. Në pjesën e parë autori tregon sikur njerëzimi fitoi vetëdijen e gjendjes së rrezikshme në të cilën ndodhej, kurse në pjesën e dytë ai e paraqit çështjen si një alternativë që s'ishte zgjidhur ende. «Mbrapa gjithë kësaj që thosh, nuk dihet një! A ka me sjellë historiku fletën krejtë të re, të shkruajë — a po do të vazhdojë fletën e vjetër? Mos asht dhe kjo vetëm një ironi kohe?» Siç shihet, vepra mbyllet me një theks skepticizmi. Pra, megjithëse në pjesën e parë rrëshqet ideja se popujve po u hapen sytë, kjo s'do të thotë se Migjeni mendonte se masat ishin ngritur në këmbë dhe po mësynin godinën e shoqërisë me klasa.

Në «Ose... ose» problemi i luftës lidhet, sikurse edhe në «Tragjedinë apo komedi», me rolin e fesë. Aluzione plot sarkazëm fshikulluese drejtohen kundër fesë, e cila në vend që të ndihmojë njerëzimin për të shpëtuar prej katastrofës që i kanosej, bekonte propagandën luftënxitëse.

Në formë konkrete rrjedhimet shkatërrimtare të luftës janë paraqitur në skicën «Të korrurat» (1938). Duke rrëfyer për fshatarët, që gjithë gëzim presin të mbledhin frytin e djersës së tyre, Migjeni tregoi se sa e huaj është lufta imperialiste për njerëzit e thjeshtë, për ata që me krahun e tyre ushqejnë të tjerët, prodhojnë të mirat materiale për shoqërinë. Lufta agresive është e papajtueshme me punën krijuese, sepse rrënon jetën paqësore të njerëzimit; ajo shkatërron bazat e zhvillimit të shoqërisë, e dënon këtë të mbesë në vend.

Te «Gogoli» (1937) Migjeni tregoi frikën që u kishte hyrë krerëve të shteteve borgjeze dhe fashiste nga e vërteta e madhe e komunizmit dhe nga rritja e simpatisë dhe e përkrahjes që po gjente në masat e shfrytëzuara të vendeve kapitaliste shteti i parë socialist, themeluar prej Leninit dhe Stalinit. Për të siguruar qetësinë e vet ata shpikën «gogolin e bolshevizmit», me të cilin trembnin njerëzit e vegjël dhe të shastisur, siç bëjnë nënat për të pushuar së qari fëmijtë. Pamjen e panikut të përgjithshëm që ka kapur klasat sunduese dhe shërbëtorët e tyre prej ndikimit të ideve çlirimtare të komunizmit edhe të shembullit tërheqës të socializmit në Bashkimin Sovjetik, Migjeni e ka krijuar duke përdorur me zotësi groteskun dhe hiperbolën fantastike. Kjo i dha shkrimtarit dorë të nxjerrë në pah me qartësi kotësinë e orvatjeve të forcave reaksionare për të mbajtur masat në nënshtrim të përjetshëm.

U zgjatëm pak në analizën e publicistikës artistike jo pa qëllim. Në ndonjë artikull kjo pjesë e trashëgimit letrar të Migjenit nuk ka gjetur vlerësimin që meriton. Madje, në ndonjë rast, duke marrë shkas nga errësira e gjuha e vështirë, skicave, pamfletëve dhe fejtoneve u mohohet fare vlera artistike⁵.

Mendimi se publicistika artistike përfaqëson pjesën më pa vlerë të veprës së Migjenit, na duket i pambështetur. Përgjithësimet e thella dhe forca e sarkazmës që godet mu në shenjë dhe shpartallon, i bëjnë këto shkrime pjesë të rëndësishme të krijimtarisë së shkrimtarit të shquar përparimtar. Nuk është fjala vetëm se Migjeni rrahu në to probleme të rëndësishme të jetës mendore dhe letrare të kohës, — dhe kjo, pa dy-

4) Po aty.

5) R. Qosja, *Dialogje me shkrimtarët I*, Prishtinë 1968, f. 210.

shim, ka rëndësinë e vet të madhe, — por se në këto shkrime ai e shfaq veten si satirik të rrallë, që zotëron për bukuri mjetet e llojit që përdori. Disa nga pamfletet e Migjenit kanë vlerë njohëse dhe artistike edhe sot e kësaj dite, sidomos ato me të cilat autori demaskoi fenë dhe artin reaksionar. Madje mund të themi se lloji i pamfletit të Migjenit, natyrisht, pa atë gjuhën e errët e plot aluzione të largëta, e ruan aktualitetin e vet krijues. Në luftën që bëjnë kundër ideologjisë borgjeze dhe revizioniste, shkrimtarët tanë të sotëm mund të mësojnë shumë nga publicistika artistike e Migjenit.

Kur flasim për këto shkrime të Migjenit, duhet të kemi parasysh dy rrethana.

Së pari, pamfleti dhe fejtoni si lloj i veçantë i artit të fjalës ka specifikën, prandaj s'duhet në asnjë mënyrë t'u paraqesim atyre kërkesat, që i drejtohen prozës artistike. Specifika e tyre qëndron në faktin se vlerësimin e ngjarjeve dhe të fenomeneve të jetës i bëjnë në mënyrë të drejtpërdrejtë, hapur. Kjo ka përcaktuar gjuhën dhe mjetet e tyre të shprehjes. Sigurisht, se në pamfletet edhe fejtonet futen në përdorim edhe elemente artistike, por këto nuk kanë funksion të pavarur artistik, ato vetëm ndihmojnë për ilustrimin e idesë së autorit. Duke u nisur nga çka thamë më sipër, pohimi, se «shumë proza të tij (të Migjenit — shënimi ynë K.B.) nuk shkojnë përtej fejtonizmit», na duket pa kuptim, përderisa shprehja e hapur e mendimeve përbën veçorinë themelore të këtij lloji, sikurse na duket pa themel orvatja për t'i mohuar atyre rëndësinë që kanë vetëm sepse ndonjë ide autori e paska thënë «pak më ndryshe në prozat e tjera ma të bukura se këto». Secila nga këto lloje, skica satirike, pamfleti, fejtoni dhe novela, ka detyrat e veta të cilat i përmbush me mjetet e veta specifike të shprehjes; secila syresh ka vendin dhe rëndësinë e vet në arsenalin e mjeteve që përdor shkrimtari.

Së dyti, kur jetoj dhe punoj Migjeni në Shqipëri zotëronte një klikë e egër reaksionare. Elementët përparimtarë dhe demokratë i kërcënonte gjithnjë ndjekja e policisë. Censura bënte kërdrinë. Shkrimtarët nuk mund të flisnin hapur; disa fakte negative të realitetit të kohës ata i vunë në pah, por kishte shumë e shumë sende të tjera të cilat ata nuk mund t'i tregonin. Në të tilla kushte natyrisht, ata u shtërnguan të përdornin aluzione, mjete specifike për të shprehur idetë e tyre. Këtë gjë e bëri edhe Migjeni në disa nga shkrimet e tij. Prandaj s'na duket e drejtë teza se «proza nuk e toleron shprehjen e pakapshme». Në gjykimin për qartësinë apo errësirën e këtyre veprave të Migjenit duhet të mos harrojmë se këto tipare ju imponuan atij nga rrethanat shoqërore të kohës dhe nuk ishin shprehje e zotërimit të mangët të mjeshtresë letrare nga ana e shkrimtarit.

Çka thamë më sipër na çon në përfundimin se publicistika artistike zë vend me rëndësi në trashëgimin artistik të Migjenit.

II

Doradorës me dhuntinë e satirikut që herët te Migjeni u shfaq edhe talenti i prozatorit, që e pasqyron realitetin me anë të pamjeve objektive realiste, që japin një skenë tipike ose e përshkruajnë portretin e një personazhi. Kështu, përkrah me pamfletet dhe fejtonet në organet e kohës njëri pas tjetrit panë dritë skica në të cilat vizatohen copa nga jeta. Por pjesën më të rëndësishme dhe më me vlerë të prozës artistike e përbëjnë

tetë prozat që mbeten të pabotuara — «Novelat e Qytetit të Veriut».

Të gjitha këto shkrime, skica dhe novela, nga pikëpamja tematike mund t'i ndajmë kryesisht në dy grupe. Një palë flet për rrojtjen e vështirë të kredhur në skamje të papërshekueshme të masave të varfëra të popullit, kurse tjetra demaskon moralin fals të të pasurve, rreshperve dhe pseudoliberalizmin e të rinjve intelektualë nga shtresat e privilegjuara. Brenda e ndryshme ideore dhe qëndrimi i ndryshëm i autorit kundrejt objektit të pasqyrimit artistik të veprave të tij, përcaktuan edhe veçoritë e këtyre shkrimeve.

Në veprat e Migjenit populli, vegjëlja pa për herë të parë vetveten. Ai solli në letërsi sfera të reja të jetës, njerëz të rinj, të cilët deri atëhere nuk kishin gjetur pasqyrim të drejtë dhe të thellë. Migjeni tha të vërtetën për shtresat e varfëra, foli për dramën e dhimbshme që shtilleshin në «lagjet e varfëra», për privacionet dhe jetën e zyrtë të këtyre njerëzve. Shkrimtari i njihte brengat e tyre, aspiratat e tyre të shtrenjta, për të cilat ata vetë nuk kishin ndonjëherë vetëdije të qartë. Në shkrimet e tij foli me gojën plot vegjëlja, që shekuj të tërë ishte shtypur dhe shtrydhur egërsisht nga klasat e larta sunduese, nga bajraktarët dhe feja. Me veprat e veta plot vërtetësi dhe realizëm të thellë Migjeni u erdhi në ndihmë masave të varfëra kundër zgjedhës çifligaro-borgjeze.

Në letërsinë para Migjenit pati një sërë shkrimtarësh, që pasqyruan në veprat e tyre anë të ndryshme të jetës shoqërore të vendit. Komedia «Katërbëdhjetë vjeç dhëndër» dhe ndonjë baladë e A.Z. Çajupit, «Andrra e jetës» e Mjedës, tregimet e M. Gramenos, M.S. Gurrës etj. janë disa prej veprave që prekën problemin e gjendjes së vegjëlisë. Në këto shkrime bije në sy interesimi i sinqertë për popullin, simpatia e tyre për vuajtjet që ai hiqte. Nuk duhet marrë si nënvleftësim për to, në qoftë se themi se megjithë rëndësinë njohëse dhe letrare që kanë, ato nuk zbuluan shkaqet e kontradiktave shoqërore të kohës. Shumica e këtyre veprave karakterizohen nga notat e keqardhjes, të mëshirës dhe fryma sentimentaliste. Ndonjëherë jeta e njerëzve të thjeshtë u kap në plan të ngushtë; u fol më tepër për shqetësimet që u sillnin atyre zakonet dhe normat e vjetra morale. Nga autorët pararendës të Migjenit vetëm Asdreni arriti të kuptojë se vuajtjet e popullit ishin rezultat i shtypjes së klasave të privilegjuara («Burri i dheut»).

Me Migjenin dhe shkrimtarët e tij bashkëkohës zuri vend në letërsi interesimi për ekzistencën sociale të popullit, për atë që ishte kryesore në jetën e masave të shtypura e të munduara, për urinë, mjerimin dhe papunësinë.

Por Migjeni bëri më shumë se çdo shkrimtar tjetër i kohës. Ai pasqyroi me forcë të madhe artistike gjendjen e rëndë të popullit nën monarkinë çifligaro-borgjeze të Zogut, jetën, mendimet dhe aspiratat e masave. Siç ka thënë me plot të drejtë bashkëkohësi i Migjenit, shkrimtari i njohur Sh. Musaraj, «Migjeni me artin e tij të fuqishëm, me thellësinë e mendimit dhe të ideve revolucionare, me diapazonin e gjerë të tematikës së tij, u dallua mbi këta bashkëkohës të tij, shkrimtarë e poetë të një brezi.⁶ Merita kryesore e Migjenit është se arriti të depërtojë në thelbin e marrëdhënjëve shoqërore të kohës dhe të pasqyrojë me forcë të madhe vërtetësi botën e të mjerëve, brengat dhe vuaj-

6) Sh. Musaraj Lavdi e përjetshme poetit tonë revolucionar, Nëndori, 1961, nr. 11; f. 138.

tjet e tyre që s'kanë ngushëllim. Për të mishëruar tragjedinë e popullit në rendin reaksionar, ai gjeti personazhe shumë shprehës.⁷ Asnjë shkrimtar deri atëhere nuk kishte treguar padrejtësinë shoqërore jo si rast i veçantë, por si ligj i përgjithshëm që drejtonte jetën në Shqipërinë çifligaro-borgjeze.

Tema e rrojtjes sociale të shtresave të varfëra u bë temë qëndrore e veprës së Migjenit nën ndikimin e vetë jetës; atë ja sugjeruan shkrimtarit pamjet e zymta të ekzistencës së masave të shfrytëzuara të popullit. Por Migjeni ishte i përgatitur për detyrën e rëndësishme që i vuri vetes si artist.

Informatat që kemi për vitet e rinisë së Migjenit dhe sidomos për kohën që kaloi në Manastir, janë të pakta dhe jo të plota. Por sado të mangëta, ato hedhin disa fije drite mbi formimin shpirtëror të seminaristit të ri. Që në shkrimet e para, u duk se te shkrimtari kishin të bënë me një njeri me pikëpamje të formuara ideologjike dhe politike; që e ka përcaktuar qartë qëndrimin e vet ndaj problemeve themelore të jetës shqiptare. Qysh në bangot e shkollës shkrimtarin e ardhëm e karakterizonte mëndja e mprehtë dhe dëshira e pashuar për të ditur gjithshka. Megjithëse fort i ri, ai tregon interesim jo të rëndomtë për moshën e tij për literaturë politike e shoqërore. Me etje të madhe lexonte libra, që rrihnin çështje të organizimit të shoqërisë moderne, të jetës dhe të gjendjes së klasave të ndryshme dhe posaçërisht të shtresave popullore, si dhe vepra, që trajtonin çështje të doktrinave politike etj. Kujtimet e bashkënxënësve dhe të atyre që e njohën më vonë, dëshmojnë se edhe interesat e tij letrare zhvillohen në përputhje me këto interesa politike-shoqërore. Shkrimtarët që i pëlqenin më tepër ishin Dostojevski dhe Gorki. Ne nuk dimë aspak se sa i njihte Migjeni këta shkrimtarë, ç'vepra të tyre kishte lexuar dhe ç'mendim kishte për ta. Dihet se që të dy këta autorë, nga pozita krejt të ndryshme ideologjike dhe estetike kanë trajtuar në veprat e tyre problemin e gjindjes së varfër, të skamnorëve, që qëndronin në shkallën më të ulët të jerarkisë shoqërore. Mendojmë se leximi i këtyre vepra-

7) Në literaturën kritike është shprehur mendimi se Migjeni nuk arriti dot të krijojë figura tipike. «Si poezia ashtu edhe proza e Migjenit, — shkruan R. Qosja — janë përplot skena urie, skamje, prostitucioni, serviliteti, hipokrizie; njeriu i tij është vetëm i zbetë, i venitur ndjenjash të pridhuna erotike, fatkeq, i dëshpëruem, e marrallë i revoltuem. Këtë tragjikë të përgjithëshme të jetës ai e tejkalon me vegimet e veta poetike dhe potencialin e pakënaqësisë së ndonji personazhi të tregimeve. Mirëpo këto personazhe mbesin se mbesin figuranta të asaj skene të hatashme jetësore meqënëse autori nuk ia del t'i ngrëjë në nivelin e tipit letrar. Mu për arsye të kësaj njëanëshmërie, shpesh herë Migjeni e zbret realizmin e vet në shkallën e natyralizmit» (Shih: Dialogje me shkrimtarë, I, Prishtinë 1968, f. 207).

Ky mendim nuk na duket plotësisht i saktë. Vërtet, në skicat «Qershijat», «Legjenda e misrit», «Moll'e ndalueme» etj. autori përshkroi portrete njerëzish pa arritur të krijojë karaktere tipike të gjallë. Heronjtë e këtyre shkrimeve vetëm sa skicohen; ne, si të thuash, shohim vetëm profilin e tyre, por nuk marrim dot ndonjë ide konkrete mbi veçoritë individuale të karakterit të tyre. Kurse, siç dihet, në tipin letrar shprehet jo vetëm e përgjithëshmja por edhe individualja, çka formon thelbin e tipizimit në letërsi. Heroi i skicës «Moll'e ndalueme» është i papuni në përgjithësi, autori nuk e ka zbuluar karakterin e tij, ne nuk dimë as si e ka emrin, pa thënë se nuk na është e njohur jeta dhe e kaluara e tij. Duke vënë në dukje këto veçori të heronjve të skicave të Migjenit, nuk duhet lidhur kjo në asnjë mënyrë me metodën

ve do të ketë ndikuar tek Migjeni në zgjedhjen e temave dhe të heronjve të vet. Nuk ka dyshim, se fjala këtu është për shfrytëzimin krijues të arritjeve të artit realist përparimtar. Migjeni ishte shkrimtar me talent të madh; sado i ri, ai diti ta gjejë menjëherë, që në shkrimet e para, rrugën e vet krijuese.

*

* *

Një nga krijimet e para të Migjenit me temë nga jeta e vegjëlisë është «Moll'e ndalueme», botuar më 1935. Në këtë skicë të shkurtër vizatohet një i papunë, që bredh gjithë ditën e ditës për të gjetur ndonjë punë, — të shkarkojë ndonjë karrocë ose të mbajë valixhen e ndonjë udhëtari — mjaft që të nxjerrë kafshatën e gojës. Vepra nuk ka subjekt, as zhvillim veprimi të jashtëm, por ka vetëm një pasqyrim të gjendjes shpirtërore, të sjelljes dhe të mendimeve të heroit. Autori e përshkruan atë si baret ngadalë e mërzitshëm nëpër rrugët e qytetit, si herë-herë ndalet për të lidhur spangon e shkarpave, që i tërheq me zhurmë gërvishëse, ose si qëndron për të shikuar reklamat e filmave të kinemave, ku paraqitet një vajzë e bukur e pranë saj një djalë i pasëm, të gëzuar dhe të kënaqur nga jeta. Ndonjëherë i bëhet se dikush e thërret, por gabohet: asnjëri s'ka nevojë për të. Autori tregon gamën e gjerë të ndjenjave të ndryshme që provon heroi duke u sorollatur nëpër rrugët e qytetit. Është dëshpërimi se ka humbur shpresën për të nxjerrë kafshatën e ditës, mëria për jetën në rehat të artistave të kinemasë, dhe revolta e turbullt kundër gjendjes së pashpresë dhe të padurueshme. Fati dhe heroi i nxjerrë në «Moll'e ndalueme» nuk janë të individualizuar. Punëtori, që i bie pëllëmbë për pëllëmbë qytetit, është figurë e përgjithshme, pa tipare të theksuara individuale: ai është i papuni në përgjithësi, përfaqësues i një kategorie të gjerë njerëzish, një i mjerë midis mijëra të mjerëve me të cilët ishte plot vendi në atë periudhë dhe si i tillë ai ka paraqitur interes për shkrimtarin. Fati i

artistike të shkrimtarit. Edhe në shkrimet e vogla përshkruese Migjeni është realist, sikurse edhe në novelat. Në heronjtë e tij pa emër janë mishëruar tiparat thelbësore karakteristike të shtresës shoqërore së cilës ata i përkasin. Nëqoftëse ata u paraqitën në plan të përgjithshëm, pa veçori të spikatura individuale, kjo lidhet me detyrën që autori i vuri vetes. Pikëzimin e gjendjes së pashpresë të shtresave shumë të varfëra, e realizoi në formën e skicës së shkurtër, e cila ka veçori specifike si lloj.

Ndryshe qëndron puna me novelat «Historia e njëres nga ato», «... Bukën tonë të përditëshme falna sot», «Studenti» në shtëpi, «Të çelen arkapijat», të cilat janë krijime të shquara realiste. Personazhet e tyre nuk janë «figuranta», njerëz pa fiziomi individuale, hiqe që shkojnë e vijnë para nesh, por tipa artistikë, karaktere tipike, mendimet dhe ndjenjat e të cilëve i nënshtrohen «logjikës» së tyre të brendshme, që është përcaktuar nga rrethanat e ligjet objektive të jetës. Në figurën e Kolës, heroit të novelës «...Bukën tonë të përditëshme falna sot...» është treguar fati tragjik i puntorit shqiptar të viteve 30, në rrethanat kur ajo nuk kishte fituar vetëdijen e interesave të tij klasore, brengat dhe iluzionet, që e kishin burimin në këtë gjëndje. Personazh tipik është edhe Nushi, në figurën e të cilit paraqitet llogjika e brendshme e karakterit të intelektualit borgjez të kohës, i cili e shpall veten si ithtar të formave të reja në jetën familjare, por nuk është i vendosur të bënte sakrifica personale në emër të idealeve morale që ushqente. Mund ta zgjasim sërën e shembujve, por na duket se edhe kështu është e qartë, se Migjeni ka krijuar personazhe tipike të gjallë, që ngërthejnë një brendi të gjerë sociale.

heroit është vizatuar si tipik për jetën e shumicës së popullit. Përmes tij shkrimtari ka treguar gjendjen, ku shtresat e ulta s'kisnin tjetër fat, veç të shtrinin dorën për të lypur, të ndiqnin rrugën e krimit ose të shisnin veten.

Në skicën «Moll' e ndalueme» bie në sy mprehtësia e shikimit të Migjenit, i cili arrin të kuptojë se jeta në mjerim është short i masave të varfëra edhe në vendet e tjera kapitaliste, që kriza ekonomike e viteve 30 u kishte tronditur themelet e jetës shoqërore dhe ekonomike.

Përveç paraqitjes së gjendjes së vështirë të një të papuni, te «Moll' e ndalueme» ka edhe një ide të dytë, që nuk është shprehur aqë hapur, sa e para, ideja e tragjedisë shoqërore të vegjëlisë punonjëse, që rendi çifligaro-borgjez i ka dënuar në pasivitet, i ka hequr mundësitë për jetë të fituar me djersën e ballit. «Vazhdon puntori ynë t'u bije pash më pash rrugëve të qytetit. Kërkon punë... Askund një karrocë e ngarkueme që ta zhgarkojë ai. Askund udhtar me valixhe në dorë, që t'u ndihmojë. Askund! Askund! S'e do kush djersën e tij. Kursesi me fitue nga dy-tre lekë». Heroi i skicës së Migjenit vuan jo për faj të vet, por sepse shoqëria nuk i jep mundësi të vërë në zbatim aftësitë e veta fizike, të punojë me nder për vete dhe për të mirën e përgjithshme. Këtu qëndron edhe tragjedia e vërtetë e masave punonjëse dhe karakteri thellësisht regresiv i regjimit të kohës. Kjo ide ka përcaktuar edhe ironinë e fortë, që e përshkon skicën fund e krye dhe që e ka tehun të drejtuar kundër shoqërisë, që e ka detyruar këtë punëtor të ecë ngadalë, me komoditet të plotë, i qetë», si zotni, megjithëse «i undshëm e xhel-mel» dhe megjithëse ishte ditë pune.

Skica «Legjenda e misrit» (1936) është një plotësim i asaj që Migjeni trajton në «Moll' e ndalueme». Ndërsa në shkrimin e parë kemi hero të papunin, përfaqësuesin e shtresave të varfëra të qytetit, në «Legjenda e misrit» është nxjerrë një malësor i varfër, që në fatin e vet mishëron tragjedinë e pjesës tjetër të masave të shfrytëzuara të popullit, të fshatarësisë punonjëse.

Në vitet 30 si pasojë e krizës ekonomike, që preku edhe Shqipërinë, vegjelia u krodh edhe më thellë në varfëri. Zija e urisë bashkë me sëmundjet epidemike përfshiu në fillim fshatarësinë e malësive të veriut, por më vonë ajo u shtri edhe në zonat fshatare të jugut. Në fshatrat po rritej pakënaqësia. Për të qetësuar njerëzit, aparati qeveritar duke dalë në rolin e atij që i digjet shpirti për popull, u shpërndau nga një grusht misër fshatarëve të krahinave që vuanin nga uria. Shtypi dhe letërsia përparimtare e kohës nuk e lanë në heshtje këtë fakt dhe e morën që andej temën për shkrimet e tyre demaskuese, N. Bulka shkroi një fejtun, ku goditi altruizmin e gënjeshtërt të autoriteteve qeveritare, që talleshin me mjerimin e popullit, që priste orë të tëra para zyrave shtetërore për një dorë misër. Por shkrimi i Bulkës nuk del jashtë kuadrit të konstatimit të një ngjarje të caktuar që zbulon qëndrimin e pashpirt të nëpunësve ndaj halleve të popullit.

I njëjti fakt i jetës u trajtua edhe nga Migjeni, por në plan më të gjerë. Qëllimi i skicës «Legjenda e misrit» fshikullon me ironi shpartalluese pikëpamjen për malësinë si zonë e paprekur prej kontradiktave, që brejnë jetën e tërë vendit. Kjo ide është zhvilluar në formë publicistike në pjesën e parë. Autori ngrihet kundër përfytyrimit mbi malësinë, si vend ku njerëzit të lumtur adhurojnë si në kohën e lashtë perënditë e tyre dashamirës. Në kohët e reja s'ka në malësi më «apoteoza perëndish», por përpjekje plot mundim për të fituar bukën e gojës,

thotë Migjeni me dhembje. Misri — ja kush i ka zënë vendin përrëndive mitologjike. «Emën përrëndish sot nuk zejnë me gojë fëmijë, që posa kanë fillue të belbëzojnë, por misër! misër! asht fjala e ditës, asht sinonim i jetës për banorët legjendarë të këtyre maleve të egra». Migjeni çohet gjithashtu edhe kundër mendimit se në të kaluarën malësorët e kalonin jetën si në rapsoditë, duke kënduar me lahutë këngë kreshnike, ose duke treguar trimërinë e tyre në dyluftime legjendare. Asnjëherë s'ka pasur shekull të artë në malet e ashpra të veriut, don të thotë Migjeni në veprën e vet. Njerëzit atje gjithnjë e kanë fituar rrojtjen e tyre me punë të mundimshme dhe plot djersë. Vetëm nga kjo pikëpamje, nga vuajtjet dhe privacionet e papërfytyrueshme për njeriun e shekullit XX mund të quhet jeta e tyre legjendë. Varfërinë e madhe të këtyre krahinave e ka të vështirë ta përfytyrojë mendja e njeriut. Por në kohën e shkrimtarit rrojtja u bë dhe më e rëndë për malësorët. «Dhe kjo legjendë e idhtë dhe plot vujtje historike, në shekullin e njëzet asht e thekshme, zemërbresë dhe të ban të qajsh».

Në pjesën e dytë përshkruhet figura e përgjithësuar e malësorit të uritur, që me një thes në krah nget vrap në qendrën e nënprefekturës, ku shpërndahet misër. «Misër për fmi të nximë nga mjerimi, të cilët kur duert shtrijnë u përngjajnë lugetënve të vocër». Sepse në malësi nuk ka gëzim, nuk ka lumturi pa misër. Jeta me bukën e gojës të siguruar për ta është vetë një mirazh. Fëmijë e malsorëve që shtrijnë dorën për bukë janë «dëshmorët e vërtetë të tragjedisë njerëzore. Dëshmorët tragjikë në këtë skaj të dheut, të cilët njerëzit e huej i kujtojnë legjenda historike». Ato nuk janë legjenda, nuk i përkasin së kaluarës. shton autori, por janë realiteti i gjallë i kohës, janë jeta shqiptare e shekullit XX. «Se lumnia e vërtetë asht larg, tepër larg, nga këto foletë e shqipeve», përfundon me pikëllim që i dërmon shpirtin Migjeni.

Me mjetet që përdor shkrimtari synon jo të individualizojë, por përmes hollësirave të goditura dhe arësytetimeve të hidhura të shprehë dhembjen e tij për pamjen tragjike që sheh. Drama e malësorit del qartë përmes antitezës artistike. Malësori, i cili i ngjet «një copë granti, që u shkëput nga mali dhe u vendos mbi kambë të drejta e të forta si landa e pyllit», ky bir i patrembur i maleve, tashti për bukën e gojës bëhet servil, thyen më dysh shpinën, duke nderuar orë e çast me përrulje nëpunësin, bëhet qesharak me gjestet e tij prej «majmuni». Me këtë skenë Migjeni ka treguar si frika e urisë i shtynte malësorët të bjernin burrinë e tyre tradicionale dhe dinjitetin e tyre prej njeriu.

Përveç kritikës së rendit shoqëror skica «Legjenda e misrit» përmban në vetvete edhe një polemikë të fshehur kundër atyre letrarëve borgjezë, që e paraqisnin malësinë si vendi ku njerëzit rronin me zanat e shtojzovallet, duke kaluar një jetë pa halle e brenga. Përfaqësues tipik i kësaj letërsie ishte Ernest Koliqi, i cili në një tok novelash të tija dha një pamje idilike të malësive të veriut, ku malësorët jetojnë në një ambient të ngjashëm me atë të këngëve epike legjendare, në mes të mirash të natyrës, në harmoni të plotë me zanat, që u a bëjnë jetën të lumtur. Migjeni, i cili i njihte mirë dertet dhe shqetësimet e fshatit malësor dhe e kishte parë me sytë e vet si malësorët hiqeshin zvarrë në jetë në mes privacionesh dhe mungesash, që të trondisnin shpirtin, u ngrit gjithë zemërim kundër paraqitjes idilike e të zbukuruar të jetës së malësisë.

Temën e jetës së vështirë të fshatarësisë punonjëse Migjeni e trajtoi edhe në skicat «Bukuria që vret» dhe «Qershijat». «Bukuria që

vret» (1936) është një pikturë e fortë realiste e rrojtjes plot llahtar e banorëve të varfër të malësisë. Jeta e këtyre njerëzve nuk ndryshonte shumë nga ajo e kafshëve, sepse nga të gjitha kërkesat dhe nevojat që ka njeriu, atyre u kish mbetur vetëm një: të siguronin ushqimin e përditëshëm për të mbajtur gjallë frymën. Kjo përpjekje bëhet më e trishtuar në dimër, kur shtohet ftohti dhe njerëzve u shterojnë energjitë. Netëve të ftohta dimërore, kur bora ngrin dhe shtang çdo gjë të gjallë në kasollet e malësorëve, jeta pothuajse ndalet. «Një dorë shtrihet, zen një dru e shpupurish zjarmin. Rropos një botë gacash. Flaka lëpin errsinën e shkëndijat kërcejnë nën tra dhe nëpër ftyra rreth votrës. E trupnat e njerzvet dridhen, nëpër kurriz u përshkohet të ftohtit, që vjen nga skutat, andej nga errsina». Çdo natë dimri e kaluar është për këta fatkeq një fitore e jetës. «Çohen njerëzit me trupnat e mpimë dhe me kuptim në ndërgjegje se u kalue edhe një natë e vështirë.»

Lufta për ekzistencë, për t'u mbajtur përballë urisë që i kanoset, i bën këta njerëz të vrazhdë, shtyp tek ta ndjenjat më të sntrenjta intime. Nga mesi i natës, kur në kasollen e ftohtë, acari arrin kulmin, vazhdon rrëfimin e vet autori, fshatarët i lëshojnë vendin Laros, lopës së shtëpisë, sepse në kërthizë të dimrit, kur në shtëpi mungon buka, kafsha duhet më tepër se vetja, me tepër edhe se fëmijët: ajo ushqen familjen. Por me të gdhirë dita një fëmijë nuk jep shënja jete; ai ka ngrirë në qoshe të kasolles, ku e kishin çuar për t'i lënë vend bagëtisë. Në këtë episod Migjeni dha me një forcë tronditëse gjithë tmerrin e skamjes në malësi, tragjedinë që s'përshkruhej dot të vegjëlisë fshatare.

«Bukuria që vret» është një skenë koncize dhe e përgjithësuar nga jeta e malësisë. Autori ka si qëllim të theksojë karakterin e përgjithshëm tipik të kësaj gjendjeje për vendin. Ngjyrat, imtësitrat sikur kanë një kumbim të veçantë, simbolik; ato nuk e individualizojnë pamjen e paraqitur në skicë, e cila del si copë e gjallë jete, si fragment i ngjeshur i varfërisë që kishte pllakosur malësinë. Aq i mënjanohet përcaktimit më të hollësishëm të gjërave dhe të njerëzve, sa edhe fjalën «Pa shiko mos ngrin Larja?» e ve, pa shënuar se kush e thotë. Duket se pyetja del nga errësira e kasolles. Çdo hollësi është futur në skicë, për ta përgjithësuar domethënjen e kësaj skene, për t'i dhënë një kuptim sa më të gjerë.

Sikurse edhe shumë shkrime të tjera «Bukuria që vret» shquhet nga fryma publicistike. Në rreshtat e shkruara me këtë stil Migjeni shtron problemin e shkakut të kësaj gjendjeje tragjike dhe të përgjegjësisë së artit para mjerimit të vegjëlisë. Në fund shkrimtari, me një apostrofe të fortë ironike, stigmatizon shkaktarët e mjerimit, dhe të vuajtjeve që heq populli. Pjesa e fundit është një tiradë gjithë zemërim kundër qeveritarëve të kohës, ministrave apo deputetëve që s'bëheshin merak për popullin, si dhe kundër artistëve, që e kërkonin bukurimin e frymëzimit për krijimet e veta jo në jetën e vegjëlisë, që vuante dhe hiqte të zitë e ullirit, po në bukurinë e ftohtë të statujave të lashtësisë klasike. Kësaj bukurie që është e largët për ndjenjat dhe aspiratat e shumicës së popullit, Migjeni i vë përballë, si objekt të artit të vërtetë «bukurinë që vret», jetën reale të popullit, hallet dhe preokupimet e tij të përditshme. Na duket se kjo polemikë me ithtarët e «artit për art» formon një nga qëllimet kryesore të skicës «Bukuria që vret». Nuk është aspak e rastit që ky shkrim fillon me një paragraf, që nis si pa-

rodi e motiveve dhe e figurave karakteristike të përfaqësuesve të «artit të kulluar», të poetëve neoromantikë dhe sentimentalistë të demoduar dhe mbaron si replikë e ashpër ironike kundër qëndrimit të tyre ndaj artit, kundër gjithë letrarëve dhe artistëve, të cilët kërkonin që arti të qëndronte larg tragjedisë së llahtarshme, që po luhej në kurrrizin e masave të varfëra.

Për kushtet e mjerueshme të ekzistencës së vegjëlisë flet edhe skica «Qershijat» (1936). Duke rrëfyer për malësoren e re, që së shpejti do të bëhej nënë, për rrojtjen e saj të zyrtë në ato vise të shkreta, duke përshkruar nuancat më të holla të ndjenjave të saj intime shkrimtari paraqet vrazhdësinë e jetës në malësi. Skamja u ka hequr njerëzve ato pak gëzime që u ka falur në ato kushte natyra, duke e reduktuar jetën e tyre në plotësimin e nevojave më të domosdoshme për rrojtje. Malësorët nuk janë shumë larg gjendjes më primitive, që ka mundësi të ekzistojë në shekullin XX. Nga të gjithë synimet dhe kërkesat e natyrshme nga e cila formohet jeta e njeriut të këtij shekulli, atyre s'u kanë mbetur veç dy nevoja, ato më të domosdoshmet: mbajtja e shpirtit gjallë dhe riprodhimi i fisit njerëzor. Por kur mungon buka e misrit, atëhere rrojtja kthehet në një luftë të vështirë, torturonjëse për të mos vdekur uri. «... Ka do kohë që edhe misri u ka munguar — thotë shkrimtari — kokrrat e fundit të tij i ruejtën për farë. Nesër duhet me i qitë në dhe, dhe mandej me pritë deri sa të bahet misri i ri. E për do kohë, misrit kanë me i xanë vendin qershijat». Dhe qershijat e kuqe janë ushqim për nusen e re malësore, që endet nën pemë e molisur nga uria dhe pret nga çasti në çast feminë e vet. Kjo pamje flet më shumë se qindra faqe të zbeta përshkruese.

Por malësorja e re s'mund ta shuajë urinë që e cfilit, as edhe me qershia. Dhe këtu zë fill tema tjetër e skicës, një temë shumë e rëndësishme. Shkrimtari tregon, se vështirësitë e jetës i kanë bërë njerëzit indiferentë, të ashpër me njëri-tjetrin. Plaka s'don t'i këpusë dy kokrra qershija nuses së uritur, megjithë lutjet që kjo i drejton. Qëndrimi i plakës nuk diktohet nga norma e moralit patriarkal. Ate e ka bërë të pashpirt dhe të vrazhdë jeta, midis privacioneve të mëdha. Këtë ide Migjeni e zhvillon nga një kend tjetër vështrimi, kur arësyet për femijën që do të lindë në mes të mjerimit dhe qëndrimit të ftohtë të njerëzve ndaj njerëzve. Malësorja e re, që po i jep shoqërisë një pjestar të ri, merr si përgjigje nga ajo ftohtësinë, indiferentizmin, që përfton në shpirtin e saj urrejtje. Dhe ç'farë mund t'i japë ajo si porosi femijës së vet, kur ta nisë në jetën e pavarur, veç urrejtjes dhe mërisë ndaj shoqërisë pyet Migjeni? «Grueja me shtatzanë, e unshme, e mjeruese, vall ç'ka do të lindi? A mundet me qenë fryt i saj prodhimi dashnuer i natyrës. Fryt i saj, i filluem dhe i lindun në mjerim, e merr në trashëgim dhe ka me u rritun në mjerim, se vuetjen dhe mjerimin e merr në trashëgim, dhe si pasojë e këtyne: urrejtjen. Urrejtia me të cilën u lind do ta bajë ndoshta cub. E cubi asht cub! Rropos dhe u ve zjarrmin shtëpijave të ndërtoeme prej vllime ligjesh shoqnore. E qi çka ep për at gja? «Ma shumë se me ma marrë shpirtin çka mund të më bani!» — përgjigjet cubi, i rrethuem me zjarrm në mes të katër murevet». Këtu kthehemi në problemin, që Migjeni e ka rrahur disa herë: kushtet e mjerueshme të jetës gjytmtojnë shpirtërisht njerëzit e varfër. Një viktimë e ardhshme e kësaj shoqërie, armike e masave të vegjëlisë, mund të jetë edhe femija e malësore së re, që bashkë me

qumështin e nënës mori urrejtjen dhe dëshirën për hakmarrje kundër kësaj bote të padrejtë.

«Qershijat» ndryshojnë nga skicat e tjera se elementin publicistik e ka në një shkallë shumë më të vogël. Idenë e vet shkrimtari e ka shprehur duke e ndërtuar veprën e vet si përshkrim konkret realist. Për mendimet, dëshirat dhe shqetësimet flasin imtësitat, të cilat kanë një domethënje të gjerë.

«Luli i vocërr» (1936) është portreti i një fëmije prej shtresave të varfëra të popullit. Luli, heroi i skicës, ka një dhëmbje e pakënaqësi në shpirt, kur sheh, se nuk është si shokët e vet të pasur, që mbajnë në këmbë çizme të reja vezulluese. Ai rri i vetmuar dhe i trishtuar në një kend të oborrit, veças nga fëmijët e familjeve të pasura, sepse në ndërgjegjen e tij prej fëmije arrin turbull dhe e paqartë realiteti i parabazisë shoqërore, viktimë e së cilës është edhe ai vetë. Migjeni e ka paraqitur bukur psikologjinë e këtij djali të vogël, vuajtjen e tij shpirtërore, kur kupton se sa mizorisht sillet fati me të.

Migjeni pasqyroj jo vetëm rrojtjen e rëndë të masave të varfëra të popullit, por tregoi si shtypja shoqërore e ekonomike, nevoja për të rrojtur, i shtynte ata drejt rënjes morale, prostitucionit, krimit dhe degjenerimit. Me gjithë cilësitë e mira të karakterit apo synimet e bukura që ushqenin, për njerëzit e thjeshtë s'kishte alternativë tjetër në jetë veç të duronin gjithshka mbi kurriz të tyre dhe bile të merrnin rrugën e veseve më të këqia njerëzore, të shkisin në honin e thellë të mjerimit, prej ku s'do të mund të dilnin kurrë.

Që të shesë një barrë dru dhe të fitojë gjashtë lekë, malësorja e re, heroina e skicës «A do qymyr zotni?» (1935), është shtrënguar të të durojë poshtërime dhe fyerje të rënda. Për të ndihmuar familjen ajo zbret herë pas herë nga malësia me një kalë dru. Por kjo punë, na thotë autori, ka disa kohë që e ka vënë në hall të madh, sepse disa njerëz të pafytyrë duan ta prekin në nder. E kjo e lëndon thellë në shpirt. Prandaj ngutet t'i shesë drutë dhe të kthejë sa më parë në malësi. Dhe kur sheh se nuk po del njeri për t'i blerë, nis e shqetësohet. «Shikon die-llin si gjithnjë po afrohet nga perëndimi. Si ka për t'u kthye në malësi nëpër terr? Me të vërtetë, ajo nuk dron prej lugetënve dhe bubazhelave, por... T'ishte plakë, nuk do të kishte aspak frikë, por... Kujtonjet si nja dy tri herësh i janë vu mbrapa do njerëz dhe së pari nuk dinte ç'lypshin prej saj... Pra, nuk dron bubuzhelat si qytetarët, — vijon autori me ironi — por njerëzit... Njerëzit i ka frikë? E pse? Pse asht e re dhe pak e bukur».

Migjeni e ka përshkruar bukur dhëmbjen e malësorese së re, të prekur thellë në nder, kur sheh se sa herë që shet barrën e druve ajo është e shtërnguar të durojë fyerjet që i bëjnë e ndofta, të pranojë të shesë edhe nderin e vet. «... ai njeri q'aty, si që tash po hec përpara saj, — ve re shkrimtari, — peshon shumë randë në kujtesën e malsorese, e cila kuqet e skuqet nga turpi».

«A do qymyr zotni» përshkruan një skenë në të cilën zbulohet një aspekt mjaft i rëndësishëm për kohën. Autori e shtjellon këtë skenë pa ndërhyrje publicistike. Ngjarja flet vetë, pa ndihmën e komenteve të shkrimtarit. Skica është e shkurtër dhe koncize. Malësorja e re, qyteti, njerëzit, përshkruhen me disa viza të shpejta, që nxjerrin në shesh në mënyrë të plotë kuptimin e ngjarjes që tregon autori.

Rrojtjen e padurueshme të masave punonjëse Migjeni e pasqyroj me forcë depërtuese sidomos në novelën «... Bukën tonë të përditëshme

falna sot...», e cila përbën një model të artit të lartë realist të Migjenit. Sadoqë më e gjatë se skicat e tjera, kushtuar gjendjes së rëndë të shtresave të varfëra, kjo vepër s'ka shumë ngjarje dhe lëvizje. Historia që tregohet është e thjeshtë dhe e zakonshme. Kola, një kamarier, mbetet pa punë. E nxori i zoti i kafes, pas pesë vjet pune të ndershme dhe korrekte, e nxori sepse nuk i nevojitesh më. Për të ushqyer familjen, gruan bashkë me djalin e vogël, i bien këmbët gjithë ditën e ditës qysh nga mëngjesi e gjer në mbrëmje vonë, duke kërkuar punë. Por askujt s'i duhet krahu i tij. Në familje, ku mungon më kryesorja, buka, nis e prishet harmonia. Për të nxjerrë jetesën, Kola shkon edhe në kryeqytet, por edhe këtu s'gjen punë. I dëshpëruar kthehet në shtëpi, kur e shoqja, për të shpëtuar djalin, që uria e kish çuar në buzë të vdekjes. kishte nisur të shesë nderin.

Duke rrefyer dramën e këtij njeriu, Migjeni ka dashur të tregojë pasojat rrënimtare të kushteve të jetës për fatin e familjeve të punonjësve të varfër. Ky problem nuk është i ri në krijimtarinë e Migjenit. Edhe në skicën «A do qymyr, zotni?» e gjejmë temën e gjymtimit e shkatërrimit moral të shtresave të ulta prej vështirësive të luftës për të fituar jetesën. Por në skicën «A do qymyr, zotni?» ky problem sa është prekur. Veprimi shkatërrues i rrethanave shoqërore dhe ekonomike mbi karakterin e njerëzve të thjeshtë është treguar në mundësi. Rezultati i tij konkret nuk është paraqitur në mënyrë të drejtpërdrejtë në novelë. Veç kësaj, duke shënuar se heroina është një malësore e re, e bukur dhe, duke theksuar se ishte për këtë arsye që ajo tërhiqte vëmendjen e kalimtarëve, shkrimtari sikur e ka topitur kumbimin shoqëror të idesë së vet. Vepra «Bukën tonë të përditëshme falna sot...» bën pjesë në ato shkrime, që Migjeni shkroi gjatë verës 1936, por nuk arriti t'i botojë. Bëhet pyetja: pse Migjeni u kthye pas një viti prap te ky problem? Kjo tregon se atë e shqetësonte fort tragjedia e familjeve të thjeshta proletare, që frika e urisë i vinte nën sëpatë për t'i shembur. Në tregimin «... Bukën tonë të përditëshme falna sot...» ai u nis me qëllim të ngulur për të pasqyruar në mënyrë më të plotë e më të thellë pasojat e kushteve shoqërore-ekonomike në jetën e shtresave punonjëse duke vënë në dukje rrënjët shoqërore të kësaj gjendjeje e jo shkaqet e rastit, të cilat në këto drama lozin rol të dorës së dytë. Për t'ia arritur këtij qëllimi skica nuk mund t'i shërbente më. Duhej një formë tjetër, që kishte mundësi të ngërthente një lëndë më të gjerë nga realiteti. Migjeni iu drejtua gjinisë së novelës, e cila kishte nisur ta tërhiqte në vitet e fundit të jetës së vet. «Bukën tonë të përditëshme falna sot...» është novelë psikologjike; subjekti zhvillohet qetë, pa efekte dhe elemente që të rrëmbejnë. Megjithatë vepra ka një dramalizëm të madh, që rri i fshehur në veprimin, i cili është shumë i thjeshtë dhe i mbledhur.

Heroi i tregimit fiton jetesën duke shitur krahun e vet të punës. Prandaj është kaq tragjike për te gjendja, kur i zoti i kafesë e nxjerr nga puna. Duke u privuar nga vendi që kishte si kamarier, ai e sheh veten në mes të katër rrugëve, pa asnjë mundësi për të nxjerrë kafshatën e përditëshme. Atë e kap një pesimizëm dhe frikë e madhe, sepse e kupton se familjes së tij i kërcënohej një jetë në uri, një gjellitje, që do t'ja shuajë dalëngadalë energjitë. Kola u gjend pa mjete jetese jo sepse nuk e njihnte veten zot të punës. Si për të polemizuar me atë që thonë përfaqësuesit e klasave të pasura se në jetë s'kanë mundësi të fitojnë vetëm dembelët, ata që s'duan të punojnë, Migjeni e

thekson disa herë, se Kola mbeti pa punë, megjithëse pronarit të kafesë nuk i kishte dhënë shkas të qajej për shërbimin e tij. Kohën kur punonte si kamarier heroin e kujton me ndjenjën e njeriut që e ka ndjerë kënaqësinë e punës: «I kujtohej vehtja si me dy-tri tabakë mbush me gota, sillej i lehtë tue shërbye shpejt, pa gabim, pastër».

Përshkrimi koncis, mbushur me imtësi të goditura psikologjike gërshetohet me pasqyrimin e ndjesive, frikës dhe dëshprimit të madh që provon heroi, kur gjendet përballë realitetit të pamëshirshëm çifligaro-borgjez. Këtu kemi përshkrime shumë të qëlluara të lëvizjeve të mendimeve e të shpresave të heroit, të kapura me mprehtësi të habitshme.

Kola, ky proletar i viteve 30, me gjithë vuajtjet që heq, nuk ka vetëdije klasore.

Gjendjen e pazhvilluar të masave punonjëse Migjeni e zbuloi sidomos në figurën e shoqes së Kolës. Fatkeqësisë që e goditi familjen e saj ajo orvatet t'ia gjejë shkakun te i shoqi, të cilin e qorton se nuk ka punuar mirë; në përshkrimin e këtyre mendimeve dhe të devotshmërisë së saj fetare, duket ironia e hidhur e Migjenit. Shpresa e kësaj gruaje të paditur te feja, e cila do t'i shpëtojë këta të mjerë nga uria, vihet në lojë bukur në skenën, ku ajo përpiqet t'i mësojë fëmisë së vet lutjen «... Bukën tonë të përditëshme, falna sot...». Efekti arrihet këtu nëpërmjet mpleksjes së planit të lartë fetar me planin jetësor. Lutja plot devocion drejtuar Perëndisë në kontrast me jetën e uritur të familjes, me dëshirat dhe pyetjet naive të fëmisë, që marrin shkas nga fjalët e vetë lutjes, vënë në pah edhe më me forcë tragjedinë e atyre shtresave të vegjëlisë së shfrytëzuar, që janë viktimë e mashtrimit hipokrit të fesë. Vetë jeta e mësoi këtë grua se është kot të presë gjë nga feja. Pasi ngrysi ditë të tëra, duke mos ngrënë veç një kafshatë të thatë dhe pasi nga të pangrënit iu sëmur rëndë djali, ajo më në fund vendosi të shesë veten për të mos vdekur urie. Në skenën e fundit, kur Kola kthen nga kryeqyteti prapë i papunë dhe sheh me sytë e vet, se e shoqja ka marrë rrugën e lavirës, skenë kjo e shkruar me një realizëm tronditës, Migjeni tregoi me një forcë të madhe bindëse si kushtet e mjerueshme, papunësia dhe uria prishnin e shkatërronin familjet e varfëra. Kjo është edhe ideja kryesore e novelës «... Bukën tonë të përditëshme, falna sot...» Me disa imtësira të shpërndara aty-këtu në vepër dhe veçanërisht nëpërmjet kujtimeve të personazheve del, se kjo familje, dikur, kur kryetari i saj e kishte siguruar një copë punë, jetonte në harmoni. Kola e donte të shogën, e cila, nga ana e vet gjithashtu kishte dashuri e respekt për të. Që të dy këta janë vizatuar si njerëz me cilësi pozitive e me një koncept të shëndoshë mbi jetën familjare. Marrëdhënjet e lidhjet në mes tyre shturren, kur Kola mbetet pa punë. Atëhere e shoqja nisi ta shikojë me sy tjetër, ta presë atë kur kthehet në shtëpi jo si dikur, e qeshur dhe e gëzuar, por ftohtë dhe zyrtë. Jeta e të mjerëve është e zbehtë dhe e varfër, don të na thotë Migjeni, duke na rrëfyer për këtë grua. Ajo është e zhveshur nga gëzimet dhe kënaqësitë që ka jeta e njeriut. Nga të gjitha këto endje këtyre u ka mbetur vetëm gëzimi i epshit. «Aty, aty asht harresa, shpëtimi, e vetëmja kënaqësi e jetës së saj verfanjake». Por mjerimi, frika e urisë u rropos jetën familjare dhe i hedh në rrugën e korrupsionit dhe të shturrjes shpirtërore dhe fizike.

Duke rrëfyer për fatin tragjik të këtyre bashkëshortëve, Migjeni përshkruan me hollësi ambientin dhe rrethanat e rrojtjes së tyre. Në goftë se në skicën «A do qymyr zotni?» jeta është paraqitur me disa

viza të shpejta, në këtë tregim personazhet paraqiten në rrethana konkrete, të pikturuara me hollësi dhe me sy të mprehtë. Mjerimi që ka kapulluar këta njerëz duket në varfërinë e madhe të shtëpisë, që ka një pamje të zhveshur dhe të ftohtë, në jetesën e tyre të zyrtë e plot privacione. «Dritarja me xhama të thyem e të ngjitur me letër: dy karriga jo të sigurt, një tavolinë e shtrembtë mbi një qilim të harruem, në qoshe fuguret e ndër qoshe të tjera pëlhura merimangash si trofejet e mshefuna të mjerimit.» Përshtypjen dërmuese që të lind në shpirt nga përshkrimet realiste të shtëpisë e thellojnë edhe më fort bisadat plot imtësi të goditura psikologjike të djalit, Lilit, me t'ëmën. Me vizatimet dhe detajat paraqitëse nga ambienti real, Migjeni e shfaq veten si vëzhgues të hollë dhe njohës të thellë të jetës e të psikologjisë së shtresave të varfëra të qytetit.

Novela «... Bukën tonë të përditshme, falna sot...» është ngritur mbi dy plane: mbi planin e drejtpërdrejtë jetësor dhe mbi atë satirik. Objekt i satirës së autorit është indiferentizmi i klasave të privilegjuara, që s'u dhimbeshin fare të varfërit. Me imtësi e bukura satirike, me të cilat përshkruan procesionin fetar. Migjeni ka zbuluar me mjeshtëri egoizmin e shoqërisë së lartë të kënaqur nga jetesa e ngushtë që bën. Te zoti Filip, pronari i kafes, ku punonte Kola, është mishëruar vetëkënaqësia dhe trashësia mikroborgjeze. Përfaqësuesit e klasave të privilegjuara shkrimtari i karakterizon përmes përshkrimit të anës së jashtme, mendimeve dhe veprimeve të tyre, që vinë në kundërshtim me thelbin e tyre. Zoti Filip shtjehet si njeri i ndershëm, korrekt, zemërdhemshur, që i digjet shpirti për të tjerët e që për çdo njeri ka të thotë fjalë të mira, ngushëlluese. Por në thelb ai është një borgjez tipik, i cili mbi të gjitha vë mirëqënjen e vet, por këtë di t'a fshehtë me fjalë dhe pamje fisnike. Funkcion demaskues ka edhe devotshmëria e tij e tepëruar fetare, që shfaq gjatë procesionit.

Në «... Bukën tonë të përditshme falna sot...» nxjerr kryet problemi që aq tepër e ka interesuar Migjenin: problemi i shfaqjes së vetëdijes shoqërore tek masat e shfrytëzuara të «njerzve n'ankant».

Duke folur për masat e varfëra ai i vizaton këta jo si njerëz që pranojnë me bindje dhe nënshtrim fatin e tyre të rëndë, por që, ndonëse mbytazi, jo hapur, protestojnë kundër gjendjes së tyre. Mirëpo në kushtet e atëhershme të jetës shqiptare ky ishte një fenomen i rrallë. Shumica e vegjëlisë ende nuk ishte zgjuar. Lëvizja punëtore dhe veprimtaria e komunistëve ishte në fillimet e saj. Pjesa dërmuese e popullit ende s'kishte fituar vetëdijen e interesave të veta klasore. I tillë është edhe heroi i novelës, i cili nuk arrin të gjejë se i cili është shkaku, që të varfërit si ai roptohen për të fituar bukën e gojës, e së fundi prapë mbesin të uritur. «Pesë vjet kësi pune. Dhe mandej në rrugë të madhe. Por as zoti Filip s'ka faj. Punë s'ka. Po kush ka faj? Askush. Nana që më lindi, — mendonte Kola. — Paskam qenë i tepërmë në këtë botë, — unë me shokët e mij që apim të gjitha fuqitë e veta për një krodhe buke — dhe këto fuqitë tona askuej s'i duhen». Ai është shumë larg vetëdijes shoqërore. Migjeni nuk e pasqyroi punëtorin e vetëdijshëm, që po ngrihej në luftë për çlirimin e vet, sepse në vetë realitetin ku jetonte, ai shihte vetëm shenjat e para të zgjimit social të vegjëlisë, kurse lëvizja e organizuar, e gjerë dhe e vetëdijshme në pikëpamje politike ende s'kishte lindur.

Në goftë se heroi i veprës nuk ka vetëdijen e forcës së klasës që i përket, dhe nuk e din nga i vjen e keqja, autori e ka të qartë se pasivi-

teti dhe nënshtrimi i Kolës e ka rrënjën në paqartësinë ideologjike të tij. Duke vazhduar fillin e mendimeve të heroit rreth shkaqeve të skamjes të njerëzve, që nxjerrin «n'ankant» fuqinë e krahut të tyre, Migjeni shkruante: «Kush ka faj?» — Kola thotë askush s'ka faj dhe aty qëndron e tanë tragjedia e tij. Vujejtja intime dëshpëruese e cila t'udhëheq në vetëvrasje» dhe pastaj duke kaluar në ton ironik, trazuar me kërcënim, vazhdonte: «Po mirë asht qi Kola mendonte ashtu e jo ndryshe. Ta dinte ai, se kush e ka fajin atëhere — eh, atëhere... Fuqitë e njerëzve n'ankant kushedi si do të veproshin». Migjeni shpresonte se do të vijë ajo ditë kur populli do të shpërngjumesht dhe do të kërkonte çlirim e vet shoqëror.

Ky besim u shpreh në tregimin «Zeneli», shkrimi i fundit i shkrimtarit, që pa dritën e botimit (u botua në vitin 1938, në nr. 28-29 të revistës «Përpyekje shqiptare»). Teza se këtu Migjeni paraqiti prapambetjen e madhe të bujqësisë, është një thjeshtësim i brendisë ideore të veprës.⁸ Gjëndja e mjerë e bujqëve, injoranca dhe prapambetja e fshatit del tërthorazi, por nuk është kjo ajo që don të thotë autori. Në këtë skicë Migjeni tregoi aftësitë, që zotëron populli i thjeshtë. Heroi i tregimit është përfaqësues i masës së talentuar, që e vret mendjen për problemet e mëdha të jetës dhe kërkon të zbulojë shkaqet e brengave dhe të dertëve që e kanë goditur. Ndonëse fshatar i thjeshtë dhe për më tepër nxënës fillorëje, Zeneli ka një botë shpirtërore relativisht të pasur dhe interesa mendore më të gjera se vërsnikët e vet. Ai vë re me dhembje se në ç'mjerim dhe privacione të mëdha kalonte jeta e popullit. Rrëfimet e mësuesit në klasë për vendet e huaja, për nivelin e lartë të teknikës dhe të jetesës së popujve të tjerë, ngjallin në shpirtin e fëmijës dëshirën për një jetë tjetër, një jetë më të mirë. Por kur sheh amullinë ku është kredhur vendi dhe ngathtësinë e autoriteteve të cilët s'bëjnë gjë për të zhdukur varfërinë dhe paditurinë e popullit, ai hidhërohet dhe bëhet pesimist. Me gjithë këtë, me kërshtërinë dhe dëshirat e tij Zeneli paraqet diçka të re, jo të zakonshme në jetën e popullit të asaj kohe.

Në lidhje me këtë çështje lypset bërë saktësimi i mëposhtëm. Mundësitë e mëdha të masave popullore Migjeni i vuri në pah në plan intelektual e shpirtëror e jo në plan politik-shoqëror. Duke rrëfyer për pjekurinë mendore të parakohshme të Zenelit, i thotë lexuesit se në popullin e thjeshtë fshihen talente të shquara, elemente me aftësi mendore jo të rëndomtë, të cilat janë dënuar të mos zhvillohen e ta shkojnë jetën në viset e varfëra malore pa vënë në përdorim aftësitë e tyre. Mendjen e zgjuar të Zenelit e shqetëson prapambetja e madhe e bujqësisë, ku ende punohet me metoda primitive, ndohtësia dhe mungesa e kushteve më elementare higjienike në jetesën e popullit dhe probleme të tjera kultural-shoqërore si këto. Zeneli është ende larg çështjeve politiko-sociale, si shfrytëzimi i fshatarësisë, pabarazia shoqërore, shtypja e aparatit antipopullor etj. S'do mend se këto ishin të vështira për moshën e djaloshtit fshatar. Po prapë fjalët plot skepticizëm, me të cilat Migjeni mbyll tregimin, dëshmojnë se vetë ai mendonte se s'mjaftonte që t'u jepesh mundësia djemve të popullit të zhvillonin lirisht aftësitë e tyre. Ai lë të kuptohet, se, për të ndryshuar jetën e vegjëlisë, duhesh diçka tjetër, më themelore. Me djem të zotë e me kulturë, që kishin dalë prej gjirit të popullit, mund të bëheshin ca përmirësime të vo-

8) V. Bala. *Milosh Gjergj Nikolla (Migjeni)*, Buletin për shkencat shoqërore, 1954, nr. 1, f. 63:

gla, por jo të zhdukeshin rrënjët e shfrytëzimit dhe të shtypjes. Kjo, mendojmë se është bindja e autorit, të cilën nuk e errësojnë notat e dëshpërimit që ngrihen nga persjatjet jo të gëzueshme që i ngjallin vetë Migjenit, pyetjet e nxënësve, biseda e Zenelit, skamja e tmerrshme e atyre anëve, për të cilën flasin me të madhe rrobat e shqyera të nxënësve, prej ku shihet lëkura e verdhë dhe kockat e dala nga të pangrënët. Novela përshkohet nga një trishtim i thellë, që i mbush shpirtin shkrimtarit, kur sheh përreth varfëri e prapambetje, megjithëse vendi ka pasuri natyrale të pakufishme dhe në popull nuk mungojnë njerëz të zgjuar dhe të aftë për të zhvilluar ekonominë dhe për të përmirësuar mirëqenjen e përgjithshme. Shkrimtari vë në dukje një nga kontradiktat e mëdha të jetës së vendit: vajtjen kot të aftësive dhe të talenteve krijuese, në një kohë kur ato i duhen popullit si kurrnjëherë tjetër. Regjimi çifligaro-borgjez me indiferentizmin e vet dhe me amullinë që kish krijuar mbyste çdo përpjekje për krijim, për të derdhur në dejtë e vendit lëng jete. Kjo e bën Migjenin t'i shikojë si të kota dhe të pafryt përpjekjet e veta për të ngjall tek nxënësit e vet dëshirën për të përmirësuar kushtet e punës dhe të jetesës në fshat; është pikërisht ky qëndrim i pashpirt i organeve qeveritare ndaj fatit të popullit dhe ay skepticizëm, që e godit Migjenin, kur mendon se është më mirë që ta lërë Zenelin të qetë atje, në fshat, përderisa mungojnë kushtet e favorshme që ai t'i verë aftësitë e veta në shërbim të popullit.

Nga pikëpamja e gjinisë «Zeneli» është një përshkrim lirik me elemente publicistike. Në vizatimin e portretit të malësorit të ri, që aspiroon drejt diçkaje të re, një vend të mirë zënë ndërhyrjet publicistike të vetë autorit, të cilat kanë formën herë të persjatjeve dhe herë të shprehjeve e të arësytetimeve të hapura mbi probleme të ndryshme të jetës së vendit.

Pjesë e rëndësishme e prozës së Migjenit janë edhe shkrimet që flasin për jetën e fundërrinave të shoqërisë.

Kur Migjeni u kthye në Shqipëri më 1932, gjendja e masave u keqësua së tepërmi. Shumë tragjike u bë ekzistenca e fshatarësisë. Kriza ekonomike i shkundi më tej bujqit, të cilët edhe kështu memzi gjëllinin. Duke mos mundur të mbahen në ekonominë e tyre të varfëra, shumë fshatarë lanë tokat dhe u derdhën nëpër qytete. Por duke mos gjetur mjete jetese, ata bashkë me zejtarët e rrënuar u shtërnguan të mbushin radhët e të papunëve. Jeta e tyre erdhi duke u bërë përherë dhe më e padurueshme. Në faqet e gazetave botoheshin fakte tronditëse për varfërinë e shtresave të ulta. Me mijëra të varfër, të zhveshur dhe të uritur, u mblodhën në qytete dhe kërkonin nga organet zyrtare misër. Nga varfëria e madhe njerëzit hanin bukë vetëm një herë në ditë, por me kohë gjendja u keqësua dhe pati raste kur njerëzit vdiqën nga uria. Përballë kësaj perspektive të errët shumë vetë prej të varfërve morën rrugën e lypësisë dhe të prostitucionit. Thellimi i mjerimit, kalimi i një numri të madh njerëzish nga masat popullore në radhët e elementëve të deklasuar, tërhoiqi vëmendjen e shkrimtarëve përparimtarë të kohës, të cilët treguan se si vështirësitë e jetës, frika e urisë i shtynin të varfërit në humnerë.

Shkrimi i parë i Migjenit me temë jetën e «flijave të skamit» është «Një refren i qytetit tem», botuar më 1934. Këtë vepër nuk mund ta quajmë as skicë artistike as edhe feljeton. Ajo qëndron në mes të këtyre dy gjinive. «Një refren i qytetit tem» nis me një hyrje gjoja

patetike, ku gjithë ironi të hidhur autori flet për refrenin «Zotni, zotni, të lutem zotni, ma fal ndoj send», të cilin e dëgjon në të katër anët e qytetit, dhe në çdo kohë të ditës, në mëngjes dhe në mbrëmje. Përmbajtjen e dhimbshme të kësaj thirrje Migjeni përpiqet ta zbulojë në kontrast me optimizmin e trëndafiltë të shkrimeve të veprave boshe të letërsisë borgjeze. Duke parodizuar stilin e motivet e tyre, ai shkruan: «Sidomos bukur tingëllon ky refren në murg të mbramjes: rrugët e qytetit marrin një deklaratë romantike (si janë të parafytyrueme ndër piktura me koloritë), njerzit, të kënaqur me jetën e ditës, shkojnë të kënaqen dhe me jetën e natës, qielli qeshet si një virgjineshë e buzët e gjithkujt janë gati t'i apin ka një të puthun dashunije... e në mes të gjithave: refren' i bukur i qytetit tem. A jeni në gjendje t'ia parafytyroni vetes gjithë ket lumni?».

Në pjesën e dytë Migjeni përshkruan një lypës dhjetë a dymbëdhjetë vjeç, me një këmbë të paralizuar, që nxjerr kafshatën e gojës, duke duruar fyerje dhe poshtërime të ndryshme. Në skenën e lypësit të vogël me zotërinë e pasur autori derdhi gjithë indinjatën dhe urrejtjen e vet për egoizmin e klasave të privilegjuara. «Njeri-zotnia», të cilit djali i vogël i kërkoi lëmoshë, personifikon egoizmin e shoqërisë së pasur, që jo vetëm s'e vret mendjen për mjerimin e të tjerëve, por fyen dhe akuzon pa të drejtë skamnorët. «Ndershmërinë» borgjeze të «njeriut — zotnie» autori e shufuron me rreptësi, tek përshkruan mendimet dhe dëshirat e tij të vockëla e vanitore dhe pastaj sjelljen e egër kundrejt fëmisë.

Skena e fundit e forcon edhe më shumë tragjizmin e jetës së lypësit të vogël që, për të nxjerrë bukën e ditës, pranon ta godasin me forcë me një tufë monedhash metalike në krye. Kjo skenë stigmatizon cinizmin e njerëzve të ngopur dhe të kënaqur nga jeta.

Skica «Në kishë» (1935) flet për indiferentizmin e kishës dhe në përgjithësi të fesë ndaj fatit të njerëzve, të shkëluar nga shoqëria. Heroi i veprës është një lypës që fshihet në një kishë nga ruajtësit e rendit publik, që e ndjekin sepse vodhi gjashtë lekë për të siguruar një copë bukë për të nesërmen. Brendinë e saj e formon përshkrimi i peripetive dhe të emocioneve, që provon heroit. Paraqitja e mendimeve të tij dhe e ambientit, në të cilën ndodhet, ndihmojnë për të kuptuar vetminë dhe hakërrimin e heroit, përballë indiferentizmit të kishës dhe organeve të shtetit çifligaro-borgjez, që nuk e vrasin fare mendjen për hallet e popullit. Hyri në kishë, thotë autori me ironi, ashtu siç kishte predikuar themeluesi i fesë kristiane: «Eni tek unë ju të dëbuemit dhe të përbuzunit e këtij shekulli, se tek unë do të gjeni prehje...». Por në qoftë se trupi i kapitur dhe i rreshkur nga vrapimi nën diellin zhuritës me të vërtetë u preh dhe u çlodh në freskinë e lagështë të kishës, shpirti i tij nuk gjeti aty qetësinë që kërkonte. Gjashtë lekat që vodhi padyshim janë një shkak i fortë për t'u frikësuar. Asnjë siguri s'ka, se nga çasti në çast mund ta diktojnë. «Oh sa mirë asht me ndejë me u shpëlodhë e me qenë i siguruem me bukë për dy ditë... Gjashtë lekë! Edhe tri ditë mund të kalosh me gjashtë lekë!» — mendon me vete lypsi, i gëzuar se ka përpara tre ditë për t'u çlodhur nga bredhjet e mundishme dhe poshtëronjëse në kërkim të kafshatës së ditës. Por kisha nuk ja zhduku frikën dhe nuk i dha ngushëllimin që kërkonte. Ai jo vetëm u gjet në mes të njerëzve të huaj në «shtëpinë e perëndisë», por aty pa se fenë nuk e ha merakun për fatkeqësinë e tij dhe të këmbëzbaturve të tjerë si ai. Fjala e padres e hakërron dhe i ngjall në shpirt

ndjenjën e protestës. «... Dhe oratorija shkon krejt mirë. Por kur padreja filloi t'u kërcënohej atyne që vjedhin, dhe n'atë mënyrë e preku n'intimitet lypsin, ky u çue, duell jashtë e te dera, mbasi plot ironi e nderoi padren, me një të shame, përshpirti: «Po si do të jetoj unë?». . . Këtë kurr s'ma the. E unë pra due të jetoj!»

Me këtë skenë Migjeni tregoi qëndrimin plot hipokrizi të kishës ndaj fatit të njerëzve të përbuzur prej shoqërisë, ndaj lypësve, vjedhësve dhe lavirave. Demagogjia fetare është kaq e dukshme sa nisin ta kuptojnë edhe vetë viktimat e padrejtësisë shoqërore.

Në skicën «Zoti të dhashtë» Migjeni u orvat të pasqyrojë qëndrimin e ftohtë dhe indiferent të shoqërisë ndaj fatit të rëndë të të mjerëve. Heroi i skicës është një farkatar, të cilin kriza e hodhi në radhën e fatzinjve që e nxjerrin jetesën duke kërkuar lëmoshë nëpër rrugët e qytetit. Por rrallëherë i japin ndonjë gjë; shumica e përcjellin me fjalën e zakonshme «Zoti të dhashtë». Por lypsi nuk dëshprohet. Nevoja për të rrojtur e shtërngon që, megjithë ashpërsinë dhe ftohtësinë e njerëzve, të mos e lërë zanatin e vet. Autori e pikturoi shumë bukur gjendjen e rëndë shpirtërore të heroit, i cili, për të siguruar një lëmoshë, është i detyruar të durojë fyerje dhe sharje. Në fjalët «Zoti të dhashtë» është derdhur gjithë indiferentizmi i shoqërisë së privilegjuar.

Lypësi i skicës «Zoti të dhashtë» është nxjerrë si viktimë e rendit me klasa. Dikur ai e nxirrte jetesën me punë të ndershme, por kriza e detyroi të marrë rrugën e lypësisë. Duke vizatuar këtë lypës, Migjeni tregon se humbja e dyqanit që kishte dhe mundimet që heq për të siguruar copën e bukës nuk e përthyen atë dhe as e nënshtruan. Në shpirtin e tij nxjerr kryet jo dëshpërimi, por mëria kundër shoqërisë që bën e veshin të shurdhër përpara tragjedisë së skamnorëve. «... mnija vetvetiu, pa arsye, rritej e pushtonte zemrën dhe trunin e tij dhe m'at çast donte të shfrejë në një mënyrë makare tue rrahë hekurin e skuqun. E kur nuk ka hekur dhe çekiç puna del e dyshimtë dhe e rrezikshme».

Lidhur me përshkrimin e ndjenjës së mërisë që i ngjallet lypësit kundrejt shoqërisë, nuk është pa kuptim fraza me të cilën autori mbyll skicën: «Prandaj me taktik, zotni, mos thoni «zoti të dhashtë!». Këtu shihet qartas, se Migjeni aludon për forcën e madhe të urrejtjes dhe të revoltës që po rritej në ndërgjegjen e të varfërve.

Heroi i skicës së Migjenit e urren shprehjen «Zoti të dhashtë!» sepse e di shumë mirë se sa fort interesohet Zoti për fatin e të zbatuarve. Këtu autori rimerr motivin e qëndrimit hipokrit dhe mashtrues të fesë kundrejt të varfërve, të cilin e kishte trajtuar edhe herë tjetër. Heroi i skicës e ka kuptuar se feja s'bën as gjë për njerëzit e varfër. «Zoti ndoshta kujdeset për trumcakët e priftent, por për mue s'e besoj. Mue dhe shokët e mij po na harron dhe bota, e si mos të na harrojë Zoti që s'na ka parasysht - thotë me vete gjithë ironi, duke sjellë në mendje fjalët plot demagogji të klerikëve, se Zoti që kujdeset për zoqtë e qiellës, s'ka me i lanë njerëzit të vdesin nga uja».

Ndër shkrimet e Migjenit që mbeten të pabotuara, është edhe «Historia e njenës nga ato». Në këtë tregim, që duket se kronologjikisht vjen pas skicës «Zoti të dhashtë», problemin e njerëzve të përbuzur e të hedhur jashtë nga shoqëria e padrejtë Migjeni e shtroi në një bazë më të gjerë.

«Historia e njenës nga ato...» është historia e dhimbshme e një gruaje të thjeshtë, që në luftën e jetës mbaron në mënyrë tragjike. Luka — heroinë e tregimit — mori rrugën e prostitucionit, jo sepe ishte njeri me karakter të shturur. «Biografia e saj deri m'atë ditë, — thotë autori, — është e thjeshtë, por plot vujejtje si e të gjitha femnave të malsis». Skamja e madhe dhe uria e detyrojnë heroinën të zbresë një ditë dimri në qytet. Në ambientin e ri të panjohur ajo s'kishte mjete jetese dhe as njerëz të afërt, por kishte shëndetin dhe rininë e saj. Që në fillim ajo e pa se për të gjithë të mjerët dhe fatkeqët si ajo, që «s'kanë jetë gjithkrah ashtë e njëllajtë»: e pamëshirshme dhe e mbushur me poshtërimi. «Dhe Lukja ishte aq e zgjuet, — ve re Migjeni, duke treguar për të, — sa që e kuptoi shpejt filosofinë e qytetit, në të cilin rronte», filosofi, sipas së cilës, për të rrojtur s'ka rrugë tjetër për këmbëzbathurit, veç t'i nënshtrohen ligjeve të ashpra të shoqërisë me klasa. Kështu ajo nisi udhën e një gruaje publike, që shet veten për të nxjerrë jetesën.

Megjithëse e dënuar të rrojë në greminën ku e ka hedhur shoqëria, Lukja nuk i bjerë krejtësisht cilësitë pozitive në karakterin e vet. Sikurse të gjithë njerëzit, edhe ajo ëndërron një jetë të ndershme, një vatrë familjare, ku të vijë e të shkrijë ndjenjat e veta të ngrira nga jeta e vet e ashpër. Në çastet kur në kokë i ngarendnin ngjarjet e jetës së vet tragjike e plot fyerje dhe kur kuptonte thellë se është «një grue që nuk prodhon», n'ato çaste vërtet të rralla, e mbulonte një dëshprim i madh, «i dhimte ajo gja që quejnë shpirt». «O sa trishtim, po thuej një dhimbë fizike ndjente, kur u kujtonte, se asht një grue që nuk prodhon». Por koha e kaluar, kur rronte e ndershme në malësi nuk kthehet më; çdo gjë ka mbaruar. Atëhere për t'i dhënë udhë trishtimit, që i buçiste nga shpirti, thyente e shkatërronte gjithçka që gjente përpara. pasqyra, gota, enë etj. Në shpirtin e Lukes rron ende e fortë aspirata për jetë të lirë e të ndershme. Të dalë nga ajo shtëpi publike, ku humbi shëndetin e rininë e vet dhe të krijojë një vatrë familjare — kjo formon ëndërrën e saj të dashur. Për të vënë në jetë këtë ëndërr ajo u përpoq vite të tëra dhe duke kursyer lek lek si koprac i keq, mblo dhi dyqind napolona, me të cilat mendon të martohet. «Tue fitue të hollat, mendonte Lukja se do të gjejë një zemër të humbun si veten, që në pleqni të ndihmojnë shoqi-shojnë. Nuk dëshronte ajo shumë. As nuk dëshronte të bajë parakalime reklamuese me burr nën krah, as të bëjë ndoj qejf tjetër, të cilin kanë të drejtë ta bajnë gratë e martueme me nderë e faqebardhë. Dëshronte vetëm të futet në ndoj skutë shtëpije, të presi pleqninë tue pasë një njeri pranë për të këmbye fjalët rreth zjarrmit ndër net e ftohta e të gjata të dimnit, në mënyrë që me ja largue merzinë e jetës shoqishojt. Qe e tanë dëshira e vakët e Lukës», — shkruan autori. Por ëndërra e saj u bë copë e çikë. Njeriu nga i cili priste ditë të gëzuara në pleqëri, doli se ishte i poshtër dhe cinik. Ky fund dhe sidomos frika e vdekjes së ngadaltë nga uria, nën mëshirën e turmës së rrugës, e bëri të çmendet.

Duke rrëfyer për Lukën, Migjeni thekson se fati i saj i rëndë nuk ishte diçka e veçantë, e rrallë për atë kohë. Të reja, që nevoja për t'u ushqyer i dëbonte nga fshati dhe i shtynte në rrugën e prostitucionit për të mbaruar si Lukja, kishte shumë. Rrënimin e jetës të sa e sa njerëzve të thjeshtë të popullit shkrimtari e shikonte si fenomen tipik të shoqërisë çifligaro-borgjeze të kohës. Këtë e nënvizon edhe titulli «Historia e njenës nga ato...» Luka me shoqet e saj ishte pjellë e var-

fërimin të llahtarshëm, në të cilin përherë e më thellë po kridheshin masat.

E marrë si temë për një vepër letrare, historia e fatit tragjik të Lukës lindi si rezultat i natyrshëm i vëzhgimeve të hidhura rreth jetës së rëndë, plot vuajtje dhe derte të masave të varfëra. Migjeni e shihte se për popullin s'kishte asnjë rrugëdalje, se edhe ata që zbrisnin në qytet për t'i shpëtuar darës së urisë, nuk i priste ndonjë fat më i mirë se ata që në malësi jeta e uritur i shuante dalëngadalë si qiri. Kjo ide del në tregim në kontekstin e mendimeve të dëshpëruara të Lukës rreth ditëve të zeza që do ta presin në pleqëri: «Kurvës së dikurshme kush i ep lëmshë?. Dhe atëhere vjen ajo vdekje e ngadaltë nga uja, — jo vdekje çasti, por vdekje e javashme, ditë me ditë, si vdesin motrat dhe vllaznit e saj në malsi».

Tehun e kritikës së vet në tregimin «Historia e njerës nga ato» në radhë të parë Migjeni e ka drejtuar kundër vetë sistemit të padrejtë shoqëror, i cili hidhte në greminë qindra e qindra të mjerë. Por për-krah me këtë Migjeni stigmatizoi hipokrizinë e shoqërisë me klasa, e cila sa për sy e faqe e dënon prostitucionin, kurse në të vërtetë, fshehurazi, e pranon dhe e inkurajon atë. Qytetërimi borgjez nuk mund të kuptohet pa këtë institucion dhe shtëpitë e tjera të dëfrimit. Për nevojat dhe pasionet e tyre të ulëta përfaqësuesit e klasave të pasura orvaten ta fshehin këtë me një frazeologji delikate, «të kulturuar», duke zgjedhur fjalë të buta, që të mos u gërvishin veshin.

Demaskimi i moralit hipokrit të shoqërisë me klasa është një nga temat më kryesore të veprës letrare të Migjenit. Por në tregimin «Historia e njerës nga ato» kritika e shkrimtarit zhvillohet në një fushë, ku moralistët, sociologët dhe filosofët borgjezë kanë bërë dhe bëjnë çmos për të fshehur thelbin shnjëzor e kriminal të shoqërisë me klasa, duke shkarravitur mijëra e mijëra faqe. Instituti i prostitucionit është thembra e Akilit për qytetërimin borgjez, prandaj nuk është gjë e rastit që Migjeni tehun e kritikës së vet e drejton pikërisht këtu. Me një ironi të hollë ai zbulon bukur hipokrizinë e frazeologjisë: të djemve «të kulturuar» të prindërve të pasur.

«Historia e njerës nga ato» shquhet për brendinë e vet të gjerë, të cilën autori e arrin ta japë jo nëpërmjet shtjellimit të një subjekti dramatik dhe as përmes të ndonjë ngjarjeje ose situatë konkrete, që merr jetë e zhvillohet duke arritur nga fundi i tregimit pikën e vet më të lartë. Fati i Lukës ndiqet që nga fillimi e gjer në fund, por jo në mënyrë të lidhur e shkallë-shkallë. Tregimi nis me përshkrimin e jetës së Lukës në shtëpinë publike dhe më pas, herë këtu e herë atje, tregohen fije nga e kaluara e saj. Kështu tregimi del me lëndën e një romani të vërtetë, por të shtrydhur e të mbetur në fazën e konspektit.

Veprimi shtjellohet me ton jo të njëlojtë: në fillim nis si me humor për të kaluar në ironi të hollë përvëluese kundër moralit borgjez. Më tej vjen tregimi i mirëfilltë i dramës së Lukës, ku tingëllon dhëmbja për jetën e humbur të njeriut, dhe njëherazi protesta kundër kushteve shoqërore-ekonomike, që sakatojnë dhe gjymtojnë moralisht njerëzit e thjeshtë të popullit.

Migjenin në disa shkrime kritike të paraqirimit e cilësuan si poet të fundërrinave të shoqërisë, duke parë këtu novatorizmin e tij si shkrimtar. Pa fjalë një shpjegim i tillë i thelbit të veprës së shkrimtarit revolucionar është i gabuar. Tema themelore e Migjenit është populli, që vuan nën shtypjen dhe shfrytëzimin e egër të rendit çifliga-

ro-borgjez. Duke pasqyruar kushtet e mjerueshme të rrojtjes së masave të varfëra, ai stigmatizoi me rreptësi sistemin e padrejtë shoqëror. Qëllimi i Migjenit ishte të demaskojë rendin çifligaro-kapitalist, që u kishte mohuar këtyre fatkeqëve të drejtën për të punuar dhe jetuar në mënyrë të ndershme; ai nuk i idealizon këta njerëz. Për Migjenin ata që ishin flakur jashtë shoqërisë, nuk ishin heronjt që ai kërkonte. Te lypësit, lavirat etj. ai shihte viktimat e rendit me klasa. Nga tipat e këmbëzbathurve, që protestojnë kundër gjendjes poshtëruese në të cilën e hodhi procesi i kapitalizimit të vendit, është heroi i skicës «Zoti të dhashtë». I mësuar ta nxjerrë jetesën me punë të ndershme në dyqanin e vet të farkatarit, atë e indonjon hipokrizia e njerëzve të privilegjuar ndaj mjerimit të të tjerëve. Por ai nuk e ka të qartë burimin e fatkeqësisë së tij dhe të shumë të tjerëve si ai, që, për të rrojtur, ishin të detyruar të shtrinë dorën. Mjerimet dhe fatkeqësia e këtyre njerëzve ishin për Migjenin dëshmia më e fortë në aktakuzën që i bëri rendit çifligaro-borgjez, klasave drejtuese dhe fesë.

*
* *
*

Krahas veprave kushtuar paraqitjes së jetës së masave të shtypura të popullit, Migjeni shkroi edhe një sërë shkrimesh, në të cilat tregoi klasat e privilegjuara.

Figurat e përfaqësuesve të të kamurve nuk i gjejmë vetëm në tregimet «Studenti në shtëpi» dhe «Të çelen arkapijat». Duke rrëfyer për vuajtjet dhe për poshtërimet që heq vegjëlja në rendin që zotëronte në Shqipëri, ai paraqiti, sado shkarazi, edhe njerëzit që qëndrojnë në majë të shkallës së jetës. Në këtë kategori bën pjesë zotni Filipi nga tregimi «... Bukën tonë të përditëshme, falna sot...», «njeriu zotni» («Një refren i qytetit tim») dhe figura të tjera të zotërve të jetës, që shfaqen në mënyrë episodike në veprat e Migjenit.

Por në qoftë se në këto shkrime të pasurit u karakterizuan nëpërmjet indiferentizmit të tyre ndaj halleve dhe dertëve të të varfërve, tregimet «Studenti në shtëpi» dhe «Të çelen arkapijat» flasin për lidhjet e tyre familjare, dëshirat, idealet dhe konfliktet e veçanta, të cilat zhvillohen në mes tyre.

«Studenti në shtëpi» është një vepër me brendi të gjerë ideore. Novela shtron problemin e liberalizmit fals të intelektualëve të rinj borgjezë. Migjeni mendon se intelektualët, që vijnë nga shtresat e pasura, ishin një forcë e vdekur, që s'bënin dhe as ishin në gjendje të bënin gjë për përparimin shoqëror të popullit.⁹

Në qendër të tregimit është konflikti i djalit të një rreshperi të vjetër me ambientin konservator-patriarkal, që në personin e të jatit përpiqet ta nënshtrojë e ta bëjë të dëgjueshëm. Sa që i vogël, nxënës gjimnazi, Nushi, heroi i tregimit, ushqente për të jatit respektin e natyrshëm të fëmijës për prindërit. Kur ishte fëmi, ai nuk shihte asgjë të keqe në përpjekjet e babait të vet për ta edukuar në frymën e traditave stërgjyshore, të konsakruara nga morali i vjetër. Për më tepër, vetë Nushi nuk kishte për t'anë vetëm respekt, por diçka më të madhe;

9) Mendimi i shprehur prej V. Balës se brendia e kësaj vepre është kritika e kosmopolitizmit të Nushit na duket i pasaktë. (Shih: V. Bala, *Millosh Gjergj Nikolla Migjeni*), Buletini për shkencat shoqërore, 1954, nr. 1 f. 64)

ai ishte për të «ideali i andërrimeve femënore». Të bëhej si babai, t'i shkonte jeta mbarë ashtu siç i kishte vajtur babait, me mall e kamje shumë, të kishte atë nam, që ky gëzonte në rrethin e rreshperëve, — ja cila ishte në fillim ëndërra e tij. Por me kalimin e periudhës së djalërisë, sidomos pasi bëri 2-3 vjet studime jasht, ai pëson ndryshime. Kontakti me botën e huaj, ku zotërojnë përfytyrime e norma të tjera morale, jeta në mes të njerëzve të emancipuar nga konceptet dhe traditave të vjetra patriarkale-fisnore, e bëjnë atë ta shikojë me sy tjetër veten dhe ambientin shoqëror prej ku kish dalë. Ndjenjat dhe dëshirat me të cilat rrojnë njerëzit e tij të afërtë, i ati, e ëma, motra dhe vëllezërit, i duken pa vend dhe të vjetëruara, që pengojnë personalitetin e njeriut të zhvillohet lirisht. Duke krahasuar mentalitetin e njerëzve të viseve të tjera të përparuara me jetën e ngushtë e të amulltë të qytetit të lindjes, Nushi i betohet vetes të kontribuojë për emancipimin shpirtëror të shoqërisë. Pasi jep portretin e heroit, Migjeni tregon se ky i ri, në përpjekje me mentalitetin konservator, përthyeret dallëngadalë dhe së fundi nënshtrohet plotësisht. Kundërshtimin që lindi në mes të Nushit dhe babait, shkrimtari e lidh jo me faktorë biologjikë, por shoqërorë. Nushi ngrihet kundër rregullave të vendosura në shtëpi dhe në përgjithësi kundër mënyrës së jetesës së familjes. Ai e di se këtë atmosferë mbytëse e ka krijuar i jati, tek i cili sheh mishërimin e gjallë të botës së vjetër. Nushi e kupton se një hon i madh e ndan me babanë si përfaqësues të brezit të kaluar, rritur e formuar me koncepte, ndjenja e dëshira të kundërta; ai e ka të qartë edhe pse ka lindur kjo kontradiktë. Qëllimin e të jatit për ta bërë edhe atë «njeri anakronik, pikturën e vet, trashigimtarin e dejë e një të kalueme të gjymtë», e kupton, por nuk lufton aktivisht kundër tij.

Si shpjegohen dështimet që Nushi pëson në përpjekjet e veta për të kundërshtuar pushtetin autoritar të të jatit dhe për të shpëtuar të motrën nga martesë me përdhunë?

Gjatë analizës së këtij personazhi duhet patur parasysh pozita që zë Migjeni në trajtimin e problemit të intelektualëve borgjezë. Si shkrimtar përparimtar, autori e kupton qartë se shtypja e individit, marrëdhënjet e vrazhda konservatore-patriarkale ndaj njeriut marrin të tilla përpjestime, që ngjallin protestë e kundërshtim edhe në disa elementë të ndershëm të klasave të pasura. Kur protagonistin ngrihet kundër mentalitetit dhe moralit patriarkal, që sundon në shoqëri, Migjeni është n'anën e tij. Kështu p.sh. duke vijuar mendimet e Nushit mbi brezin e vjetër, si ruajtës së traditave anakronike në jetën familjare e shoqërore, Migjeni shkruan, duke hapur një parantezë të gjerë, që përfshin mendimet dhe preokupimet e të gjithë brezit të ri, «E gjithë mosmarrëveshja, të gjitha moskuptimet vijnë nga se të gjithë kemi nëpër shtëpia, nëpër votra, ka një — ose ma tepër — të këtillë të dashtun dhe t'urrejtun përnjëherësh. Çashtja me ta qëndron si çashtja e një operacioni: ose të presish kambën dhe të rrosh, ose mos ta presish kambën dhe të vdesish. Kush ka pasë fat me iu smund ashtu kamba, nj'at të dalun ka». Autori mendon se për të mposhtur pushtetin e fortë të ambientit duhen veprime të guximshme. Lufta e nisur lypset çuar deri në fund, pa u stepur përpara vështirësive. Kurse heroit i tregimit nuk ka forca për luftë të vendosur. Humbja e tij në ndeshjen me ambientin e mykur erdhi për shkaqe subjektive. Pasi i shkoi bosh ndërhyrja që bëri për Ajen, Nushi përpiket t'ia hedhë fajin atmosferës që e rrethon, e cila nuk përkrah e nxit iniciativat e vlefshme në lëmin shoqëror

e familjar. «Qe një rasë ku duhet me tregue fuqin' e ndërgjegjes, të mendimit dhe të dashnis' për me shpëtue diçka nga zakonet fatale. Por, kush të len! Ajri me miya zura, ku të len të jetosh një jetë të shndoshtë. Më kot u betove në vetvete për kontributin e vet në shoqni, për gjestet ideale! Qe një provë ku psove dështimin», mendon Nushi me vete, duke dashur të justifikohet se nuk pati sukses në përpjekjen e vet, por në të njejtën kohë duke pranuar falimentimin e vet. Shkaku i dështimit të tij e ka burimin tek karakteri i tij i pavendosur, paafësia për veprime të guximshme, mungesa e ngulmërisë në arritjen e qëllimit. Përkrah me këtë autori thekson tek personazhi mungesën e konsekuencës në aspiratat që ushqen. Megjithë dëshirën e sigurtë subjektive për të ndryshuar konceptet dhe zakonet ekzistuese, Nushi nuk u shkëput plotësisht prej psikologjisë patriarkale. Në qoftë se mendorisht e ndan veten nga ambienti konservator, në të cilin rrojnë njerëzit e familjes së vet, thotë Migjeni, në pikëpamje shpirtërore e sentimentale, ai mbeti pjesë e këtij ambienti. Prandaj, kur i jati e qorton pse rrin me djem që s'janë as të rangut dhe as të fesë së tij, Nushi ul kokën dhe i shtrohet vullnetit të babit. «E, Nushi ndëgjon. Don me qenë djal'i mirë. Si mos me digjue babën, i cili e lindi, e rriti dhe e bani kaqi. Pa le mos ndëgjo. Megjithëse kundra ndërgjegjes së vet, Nushi ndëgjon. Nga fjalt e t'et i shtrembnohet fytyra, por me ndëgjue — ndëgjen», — vren autori me ironi.

Te heroi i novelës Migjeni demaskoi pseudoliberalizmin e intelektualëve të rinj borgjezë të kohës. Megjithatë në qëndrimin e autorit ndaj personazhit ka diçka jo të qartë. Duke e bërë Nushin të heshtë para sjelljes së motrës, Migjeni don të tregojë se heroi nuk pranon normat e moralit patriarkal-konservator, sipas të cilit Agia duhet të vritet. «Tashti pra, para një ore, duhej të ngjante diçka. Po, mendonte Nushi me vetvete. Po si atje ndër malet tona primitive. Duhej të gërsitte pushka. T'u bindte i madh e i vogël! T'u lante nderi. Të vdiste dikush e shoqnia të kënaqej. Jo se asht shpirtkeq, po pse në qytetin tonë asht mërzi e madhe e me la nderin me pushkë asht një sensacion i madh, i cili nuk të len të mbyllësh syt' për do netë. Po vret mërzinë». Këtë moral Nushi e dënon si të egër, primitiv, shnjërzor. Qëndrimi i Nushit ndaj aktit të Agës nuk duhet parë vetëm si formë e hakmarrjes personale kundër kërkesave të moralit patriarkal; me sjelljen e vet ndaj çështjes së Agës ai tregoi se në kërkesat e veta për një transformim të shoqërisë nuk kapërcen kufijtë e emancipimit borgjez. Ai nuk është për një emancipim të vërtetë, që e çliron plotësisht njeriun nga zgjedha e moralit të shoqërisë me klasa; ai është për emancipimin e moralistëve borgjezë, për të cilët ka rëndësi dukja, ana e jashtme, e jo thelbi. Për ta shkelje morali ka atëhere kur e merr vesh këtë punë bota, njerëzit e huaj. Prandaj kryesore ata konsiderojnë ruajtjen e nderit faqe botës. «Bani çmos që të mos shkaktoni skandal» — flet me ironi Migjeni, duke pasur parasysh hipokrizinë e moralit sundues, dhe vazhdon: «Të shkëlqejë lustra e marrdhanjëve tona të përditëshme me shoqi-shoqin, të shkëlqejë si këpuca e lustrueme në baltë».

Duke qenë në thelb një intelektual borgjez, që nuk shikon përtej deklaramit të së drejtës së njeriut për lumturi, ai pajtohet me moralin hipokrit dhe me këtë e shfaq veten si pjellë të shoqërisë borgjeze. Me këtë zbulohet qartë dështimi i plotë moral dhe mendor i heroit para moralit patriarkal.

S'do t'ishte plotësisht e drejtë që «Studenti në shtëpi» të kun-

drohesh vetëm si histori e një të riu intelektual borgjez, që dështon në orvatjet e veta për t'iu imponuar rrethit familjar prapanik në drejtim pozitiv. Në këtë novelë Migjeni vret larg; ai polemizon me shkrimtarët borgjezë, të cilët në veprat e veta idealizonin ambientet e familjeve të pasura borgjeze dhe të rinjtë intelektualë, që rridhnin nga këto shtresa. Një nga këta autorë ishte E. Koliqi. Në përmbledhjet e tij «Hija e maleve» (1929) dhe «Tregtar flamujsh» (1935) ka një tok novelash («Kopshti», «Kumbulla përtej murit», «Bylbylat e Plepishtit» etj.), në të cilat djemt e rreshperëve të pasur janë pikturuar me tipare romantike, plot dëshira dhe endërrime fisnike. Heroi i «Kopshtit» është një intelektual borgjez, i cili kthehet në qytetin e lindjes pas dhjetë vjetësh në vendet e huaja, dhe menjëherë shpejton t'i kthejë vizitën një kushërire të largët. Ndonëse në përgjithësi i kishte mërzi vizitat, tek kjo familje shkon me qejf, sepse me shtëpinë e tyre ishin lidhur kujtimet më të bukura të kohës së feminisë. Me ndjenjë të veçantë, thuajse të shenjtë, zbret të shohë kopshtin, ku kushedi sa herë kishte argëtuar dhe përpiqet të sjellë në mendje çastet e lumtura që i fali atij shoqëria me një vajzë të moshës, të shijojë edhe një herë vitet e gëzuara të kohës së feminisë. Ai jeton disa çaste si në ëndërr, ku i duket vetja prapë fëmijë, duke u rrokullisur nëpër bar ose duke u kacavjerrë mbi pemë. Kjo përtritje e kohës së kaluar është për të një kënaqësi e madhe, për të cilën ka menduar vazhdimisht gjatë kohës që jetoi jashtë. Tipin e të riut që nanuris në shpirt dëshira të tilla të vockëla dhe t'i japë atyre rendësi të veçantë, e gjejmë edhe në novelën «Kumbulla përtej murit», në të cilën kemi një situatë të ngjashme me atë të tregimit «Kopshti». Si njerëz me shpirt të zgjedhur dhe ndiesi të veçanta, të holla, të rinjtë e shtresave të kamura janë pasqyruar edhe në tregimet «A ta lashë» dhe «Bylbylat e Plepishtit».

Për Migjenin, i cili detyrën kryesore të rinisë përparimtare e shihte në përmirësimin rrënjësor të gjendjes së popullit, intelektualët e rinj borgjezë nuk ishin një forcë aktive, e aftë për të kontribuar efektivisht për përparimin e vendit. Duke hetuar thellë jetën shoqërore të kohës, Migjeni erdhi në përfundimin se të rinjtë intelektualë nga klasat borgjeze, mund të flirtonin përkohësisht me ide përparimtare, por në fund të fundit ata mbeteshin mbrojtës të rendit në fuqi. Kjo është ideja kryesore që Migjeni përçoi në novelën «Studenti në shtëpi», e cila ka nëntekst polemik. Në kundërshtim me shkrimet e Koliqit, Migjeni tregoi se të rinjtë intelektualë nga shtresat borgjeze janë frikacakë dhe të pavendosur për të kapërcyer rrethin e ideve dhe përfytyrimeve të ambientit të vet; ata i druhen veprimeve radikale e të guximshme. I tillë është edhe hero i «Studentit në shtëpi». Sa herë që sheh se rrjedhja e arësytetimeve të tij po e heq drejt «teorive materialiste», siç i quan idetë demokratike konseguente, Nushi sprapset me frikë. Mendimi se ndonjëherë mund të gjendet përballë klasës së vet si armik i saj, është ajo që i tremb më tepër se çdo gjë pinjollët e shtresave të pasura. Jo vetëm kaq. Po Nushi s'do të shkojë deri aty sa të pranojë kalbësimin e plotë të familjes borgjeze. Në këtë mënyrë Migjeni i hoqi inteligjencës borgjeze aureolën romantike të forcës më të gjallë e më pozitive të jetës shqiptare të atëhershme, me të cilën ja kishte zbukuruar ballin E. Koliqi me shokë.

Demaskimin e familjeve të pasura Migjeni e vazhdoi edhe në novelën «Të çelen arkapijat». Shkasin për këtë tregim autorit ia dha

shpallja në vitin 1936 e reformës së heqjes së përçes. Migjeni e kishte të qartë, pa dyshim, se qeveria e atëhershme e mori këtë iniciativë për qëllime demagogjike. Në rrëfimin e autorit rrëshqet një notë ironike, kur tregon për ata që e morën këtë iniciativë. Por vendin kryesor në novelë e zë një familje rreshperësh të pasur. Pjesëtarët e rinj të saj rrojnë në një atmosferë mbytëse, ku ndrydhen e shtypen ndenjat e natyrshme të njeriut dhe zakonet e ashpra ua mohojnë të kenë një jetë shpirtërore, të gëzojnë të drejtën për të pasur në dorë fatin e tyre. Kryetari i familjes Oso Bakalli është tipi i fanatikut që e tremb çdo gjë e re, që cënon sadopak rendin e vjetër patriarkal, të vendosur në shtëpinë e vet. Prandaj e lufton me tërbim depërtimin e së resë në jetën familjare. Në karakterin e Oso Bakallit është mishëruar bota e vjetër me injorancën dhe egërsinë e saj. Dridhjet e Osos, kur merr vesh se do të humbasë pushtetin e vet mbi një pjesë të njerëzve, Migjeni i ka dhënë me ngjyra satirike, duke përdorur me mjeshtëri hiperbolën e teprimin e imtësirave. «Krenave, të mundueme vetëm me hallet ma të thjeshta të familjes, vetëm të shtëpis', tash për një herë u bjen me mendue mbi diçka të përbashkët, mbi një problem kolektiv dhe pronarët e atyne krenave gjinden si peshqit në ranë. «Me zbulue gratë!» — këtë s'e kanë mendue se do u bahet për së gjalli.

Osja rrin në minder, pin cigare mbas cigare, dhe mendon gjithçka dhe asgja nuk mendon. Po mendon se si mashkujt janë me të vërtetë të këqijë, si kanë qejf me e pa gruen e huej, dhe të shokut të vet, si i shkon mendja mandej te puna ma e keqe. I din Osja mendimet e mashkujve se dhe vetë asht mashkull. Dhe ai vetë mendon ashtu me gjithë të katërdhetë vjetët e tija dhe me gruen pranë.

— M'u hiq syvet! — i bërtiti grues kur kjo iu avit dhe me gje-lozi e mati me sy që nga kamët deri në krye.»

Bashkë me lidhjen e ngushtë me traditat dhe konceptet e vjetra Migjeni tregoi edhe injorancën e madhe të mbrojtësve të zakoneve të vjetra në shoqëri. Frika e këtyre njerëzve përpara së resë nuk vjen aq nga rreziku i vërtetë, real, se sa nga disa përfytyrime të shtrembëra që ata kanë mbi jetën. Ideja e fiksuar se emancipimi i femrës është diçka e palejueshme, i shtyn përfaqësuesit e botës së vjetër të marrin veprime, me anë të të cilave arrihet një efekt i kundërt. «Arkapijat» që çelen nuk ruajnë moralin, por krijojnë mundësi të fshihen më mirë veprimet, të cilat ata përpiqen t'u presin rrugën. «Me anë të arkapive mund të bahen dhe shumë gjana tjera; hanemet dhe haket e dinë, por çka me bamë kurse nuk guxon me dalë në rrugë me perçe. At natë Osja ra kondend, pothuej i kënaqun, ne dushek, tue thanë me vete: «nuk po i shef, nuk po i shef gratë ai mashkulli i keq fëdull, që pret përjashta në rrugë. Mendimi i krijuem nga xhelozia e tij fantastike.» Pra, nuk është çështja e mbrojtjes së nderit, që i shqetson këta njerëz, por ruajtja e atij rendi prapanik, i cili shërben si perde prapa së cilës kryhen sa e sa fenomene të pahijshme. Kthehemi kështu prapë te hipokrizia e moralit të shoqërisë, por kritikën e saj Migjeni e bëri këtu me forcë më të madhe demaskimi.

«Të çelen arkapijat» është një vepër satirike. Frika, shqetësimi, hakërrimi i heroit të veprës Oso Bakallit është dhënë me tone komike-jetësore. Duke përshkruar emocionet që provon dhe hapat që ndërmerr ky njeri, autori zbulon kotësinë e përpjekjeve që ndërmerr bota e vjetër për të penguar futjen e formave më të zhvilluara të jetës.

Migjenin e tërhoqi edhe problemi i dashurisë. Dashuria në rre-

thanat e rendit të atëherëshëm shogëror, ku sundonte morali patriarkal konservator, i cili pengonte zhvillimin e ndjenjave të njerëzve dhe u mohonte të rinjve të drejtën për të shijuar gezimet e jetës, liria në dashuri — ky është rrethi i gëshhtëve që preokupuan Migjenin. Në «Studenti në shtëpi» dhe «Te gelen arkapijat» problemi i të drejtave të njeriut për të dashuruar lirsh, për të shfaqur ndenjat e veta të natyrshme zë një vend të rëndësishëm. Si Agëja të «Studenti në shtëpi» ashtu edhe Hajrija të «Te gelen arkapijat» vuanë në zgjedhën e rëndë të moralit patriarkal, i cili u ka mohuar të drejtën për të patur një jetë intime dhe të zotërojnë fatin e tyre. Ages in shkatërrua jeta për shkak të zakonëve të vjetra, që ndoqi e shërnguar nga familja dhe në mënyrë të vegante nga i jati. E edukuar të jetë e përulur dhe ti nënshtrohet urdhërit të familjes, ajo s'pati fuqi të ngrihet kundër këtyre pengesave. Një fat të tillë e pret edhe Hajrija nga tregimi «Te gelen arkapijat». Atë nuk e lenë as edhe të ëndërojnë për një jetë të lirë dhe dinjitoze. Çdo shtaqje e dëshirës së saj për liri pritet me egërsi dhe ashpërsi nga ambienti, i cili e ka përcaktuar me kohë fatin e skllaves së pagojë.

Në skicën «Puthja e cubit» të Migjenit kemi poetizimin e ndjenjës së dashurisë. Sfondi lirik në të cilën është vendosur heroina, një vajzë e thjeshtë malësore, lidhja e dashurisë me ardhjen e pranverës, që deh njerëzit me aromën e freskisë, ngrohtësia e ndjenjave, imtësirat e gjalla i japin tregimit një frymë të theksuar lirike. Tek heroina e veprës së vet Migjeni vë re një ndjesi të tillë jete, që ishte karakteristikë për njerëzit e periudhës së Renesansës, për të cilën ishte karakteristikë kulti i gëzimeve të jetës. Përveç apoteozës së dashurisë, «Puthja e Cubit» fshih edhe një ide tjetër. Duke treguar për Dilen dhe ndjenjën e saj, Migjeni sikur don të thotë se shtaqja e lirë e ndjenjave ishte e mundshme vetëm në rrethanat e jetës së thjeshtë të malësisë, ku nuk ndryshen ndjenjat njerzore.

Dashuria është tema, që Migjeni trajton edhe në novelën «Pak poezi». Heroi i kësaj vepre është Lili, një djalosh që vuan shumë nga dashuria për vajzën e tezës së vet. Duke e kuptuar se dashuria e tij është e parralizueshme ai mbushet plot mëri kundrejt njerëzve që e rrethojnë, këtyre «skllavëve të dokëve, zakoneve, ligjeve të trashigueshme me shekuj», sig thotë vete, të cilët nuk mund të kuptojnë, se «mund të dashunohet edhe një kushtinë». Në vepër ndjehet një notë simpatije për heroinë, i cili përpelet në daren e ndjesisë së vet. Autori përpiqet të justifikojë sjelljen e tij duke iu referuar zakoneve prapanike që shtypnin ndjenjat e natyrshme të njeriut, të cilat, duke mos gjetur zhvillimin e tyre shfrenin në forma të përgudshme dhe të neveritshme.

«Në sezonën e mizave», datuar «maj 1936» dhe mbetur pa botuar, zë një vend si më vete në prozën e Migjenit. Në këtë vepër nuk kemi një pasqyrim të zakonshëm të ndonjë aspekti të realitetit shogëror të kohës.¹⁰ Sipas nesh, ky shkrim është parodi kundër E. Koliqit, i cili në disa novela të tij kishte idealizuar ambientet borgjeze shkodrane, sidomos intelektualët nga këto shtresa.

10) Shih K. Bihiku, *Rreth gëshhtës së idesë dhe gjynisë së shkrimit të Migjenit «Në sezonën e mizave»*. «Përmbledhje artikujsh me rastin e 10-vjetorit të vdekjes së A. Xhuvanit».

Migjeni zbuloi zbrastësinë shpirtërore të të rinjve nga shtresat e pasura, meskinitetin e endërrimeve dhe të aspiratave me të cilat është mbushur jeta e tyre. Duke përdorur asociacionin dhe imtësiat satirike, autori i rrezon këta heronj nga piedistali, ku i kish vendosur nga shkrimtarët borgjezë, i shvleftëson në sytë e lexuesve.

Në trashëgimin letrar që na ka lënë Migjeni ka një varg veprash që ose kanë mbetur të papërfunduara (M'at anë gardhit asgja të re», «Kanga e qytetit të huej» dhe «Kusarët n'Adriatik») ose janë të mangëta («Kanga e trumcakut»). Në tregimin «M'anë gardhit asgja të re» autori kishte ndërmend të tregonte historinë e një familjeje, jeta e së cilës është e mbushur me shqetësime të parëndësishme. Ambienti që përshkruhet aty na kujton atë të novelës «Të çelen arkapijat», ku jeta rrjedh ngadalë e plot mërzitje, pa ngjarje të veçanta. «Kangën e qytetit të huej» mund ta konsiderojmë një artikull, ku duket se Migjeni jep përshtypjet e veta rreth jetës në Torino, ku vajti më 1937 për t'u mjekuar dhe studjuar. Shkrimtarit, të ardhur nga Shqipëria, jetën e së cilës në atë kohë e kish pllakosur amullia, e tërheq dinamizmi i qytetit kapitalist, atmosfera e gjallë dhe plot lëvizje, në të cilën lëvrijnë njerëzit. Autorit i duket se forca që vë në lëvizje atë mori njerëzish që shkojnë në kinema, dëfrenë në kabare, ose kalojnë kohën nëpër kafe nate, është dëshira për të shijuar gjer në fund gëzimet e jetës, e cila është e shkurtër. Ky entuziazëm përpara pamjes së qytetit që dehet në shijimin e jetës, vinte nga gjendja shpirtërore e autorit në atë kohë. I sëmure rëndë, me parandjenjen se jeta e tij po shkon nga fundi, Migjenit për një hop i duket se banorët e qytetit jetojnë vetëm me një qëllim: të plotësojnë dëshirat e veta, të dehen me ëmbëlsirën e jetës. Me dëshpërimin në gji për ndjenjen e papërmbyshur të dashurisë për jetën, ai pa vetëm këtë anë, anën e jashtme të jetës së qytetit kapitalist, «Husarët n'Adriatik» është një përshkrim humoristik i një udhëtimi me vapor për në Itali. Në tërësi, po të përjashtojmë ndonjë aluzion për jetën e vështirë që bëjnë masat e gjera në Shqipëri apo për marrëdhënjet shqiptaro-italjane të asaj kohe, vepra nuk ka ndonjë vlerë. Migjeni flet për të zité që heqin udhëtarët, kur anija nis e tundet nga dallgët. Imtësiat që vë re shkrimtari janë të mprehta, përshkrimet të goditura, ku nuk mungon edhe ndonjë notë humoristike. Autori bën një paralelizëm në mes të ilirëve që çanin me guxim kryq e tërthuer Adriatikon për të grabitur anijet e huaja dhe udhëtarëve shqiptarë që i leqendis keqas sëmundja e detit. Por, duke treguar peripecitë e tyre, autori nuk i vuri vetes ndonjë detyrë të rëndësishme.

Shkrimi i fundit letrar i Migjenit është «Kanga e trumcakut», që mban poshtë shënimin «Senatorium, prill 1938». Kësaj skice satirike i mungon faqja e parë, e cila humbi në tallanditë që kaluan dorëshkrimet e Migjenit. Nga pjesa që ka mbetur del se tema s'është e re për krijimtarinë e shkrimtarit. Është kjo tema e pesimizmit të shtirur të shkrimtarëve të vonë romantikë, të cilët kontradiktat e jetës reale përpiqen t'i kapërcejnë me skepticizëm dhe mospërfillje të lehtë kundrejt botës që i rrethon. Por është e pamundur të fitosh një ide të plotë për këtë skicë, përderisa nuk e kemi në dorë të plotë.

E datës 15 maj 1938 është një shënim i shkurtër, ku Migjeni na flet për gjendjen e tij fizike dhe shpirtërore në senatorium, për planet dhe mendimet që ka. Shënimi ka karakterin e një dokumenti dhe pa-

raçet interes për të studjuar biografinë e tij. Nga ky shkrim del se në ditët e fundit të jetës së vet të dhimbshme, deri sa i regëtiu zemra në kraharor, ai nuk e la pendën, por jetoi dhe mendoj vetëm për artin.

*
* *

Proza e Migjenit përbën një nga faqet më të rëndësishme të letërsisë përparimtare të viteve 3. Migjeni solli shumë elemente të reja në letërsinë shqiptare, në radhë të parë pasqyrimin e jetës sociale të masave të varfëra të popullit dhe të pakënaqësisë së tyre ndaj zgjedhës çifligaro borgjeze. Rëndësia e Migjenit si prozator u përcaktua nga thellësia e realizmit, i cili përfaqëson një nga arritjet më të shquara të tij, nga ngërthesa e gjërë sociale dhe nga psikologjizmi që shquan veprat e tij të periudhës së pjekurisë artistike.

Migjeni vdiq në një kohë, kur, siç e tregojnë shkrimet e tij të pabotuara, ai po rritej në një mjeshër të shquar të prozës realiste sociale.

R é s u m é

LA PROSE DE MIGJENI

Cet article représente une caractérisation d'ensemble et à tous égards de la prose de l'éminent écrivain réaliste albanais des années 30. La thèse principale soutenue par Bihiku est que le talent de Migjeni s'est manifesté en prose avec la même force et originalité qu'en poésie. Une fois établi ce point de départ, Bihiku passe à une analyse détaillée de toute la production en prose que nous avons de Migjeni.

Dans la première partie de l'article il analyse des pièces brèves, qui ont pour sujet des questions philosophiques et sociales, la question de l'essence de l'art dans la société de classe, etc. («Socrate souffrant ou cochon satisfait», «Ou bien... ou bien...», «Tragédie ou comédie», etc.). Ces esquisses sont considérées comme des genres de la publicistique artistique.

Dans «Socrate souffrant ou cochon satisfait», Migjeni, d'après l'auteur de l'article, brosse la tragédie de l'existence de l'homme dans une société où règne l'hypocrisie. Au fondement de l'esquisse «Tragédie ou comédie» réside l'idée que l'homme de notre siècle est une marionnette, un esclave des préjugés et des conceptions qu'il s'est créées lui-même durant les âges. Si les productions générales se rattachent à la vie albanaise, dans «Idoles décapitées», Migjeni a souligné le problème que les idées et les formes anciennes doivent être substituées par des idées et des formes nouvelles de la vie.

La question de la guerre et de l'attitude des peuples envers celle-ci, la mise au nu de son essence anti-humaine, est débattue dans les esquisses «Ou bien... ou bien...» et «Les moissons». Les questions importantes de la politique contemporaine forment aussi le fond de l'esquisse «L'épouvantail», où l'auteur démasque les tentatives des pays impérialistes à faire détourner, aliéner les peuples du monde de l'influence libératrice des idées communistes au moyen du bobard de l'«épouvantail bolchévik».

Dans les analyses des esquisses «Conte sur la crise», «Le suicide du moineau» et le «Programme d'une revue», Bihiku fait ressortir toute la maîtrise de Migjeni dans sa conception créatrice et sa force d'extériorisation: notre auteur parvient à stigmatiser par une force véritablement rare, le bobard de l'«art pour l'art», de l'«art en dehors de la politique».

Une ample place dans cet article critique a pris l'analyse des esquisses et des nouvelles réalistes, consacrées à la condition des opprimés et des pressurés. Bihiku a examiné tour à tour et une à une ces pièces qui parlent de la vie du petit peuple, en faisant ressortir l'attitude de l'auteur envers cette question. Migjeni a visé de faire ressortir, avant tout, les conséquences funestes de la dure oppression dans la vie des masses exploitées. Ecrivain au regard investigateur attentif, il a reproduit dans ces esquisses des tableaux de la vie, qui ont mis au nu la tragédie des va-nu-pieds, des hommes rébutés, flanqués en dehors de la société injuste. Parlant de la misère et de l'indigence qui avaient envahi latéralement la population. Migjeni les considère un résultat de la dure oppression féodalo-bourgeoise exercée sur ces masses.

Les esquisses «Le fruit défendu», «A l'église», «Va-t-en avec Dieu», etc., Migjeni a parlé de la situation sans issue dans ces conditions du petit peuple, qui traînait son existence dans la débîne et souffrant aussi de la famine.

C'est par un réalisme émouvant que Migjeni reproduit la vie dure, aux tracasseries infinies, aussi dans les esquisses «Les cerises», «Beauté mortelle», «La légende du maïs», «Du charbon, monsieur!» etc. Dans ces productions, Migjeni a prononcé en termes nets la vérité sur la vie des Malessores qui résidaient aux marges de la vie, il a tracé les effets néfastes de la misère sur le caractère des gens du commun, sur leurs destinées.

A une analyse détaillée sont soumises les nouvelles «L'histoire de l'une de celles-là» et «Donnez-nous notre pain quotidien». Bihiku les considère comme des tableaux réalistes vivants de la misère indescriptible de la vie des gens du commun, de leur condition sans issue, de l'action destructrice des rapports sociaux injustes sur la vie du petit peuple. Les mérites de l'écrivain sont considérés dans le fait qu'il a créé des caractères typiques, qui incarnent dans leur sort tragique les particularités essentielles de la vie sociale de cette époque. Dans le même temps il fait ressortir la maîtrise psychologique et le savoir-faire de l'auteur dans la représentation des caractères.

Un autre groupe de productions analysées par Bihiku sont celles qui brossent sur un plan satirique les représentants de la bourgeoisie provinciale, pataugeant dans les conceptions et les coutumes patriarcales («L'étudiant chez lui» et «Qu'on ouvre les poternes»).

L'article de Bihiku se termine par un bref aperçu des productions portées à terme par Migjeni.

De tout ce qu'on vient de dire ci-dessus, Bihiku arrive à la conclusion que Migjeni a apporté une foule de nouveaux éléments dans les lettres albanaises, et en tout premier lieu le reflet de la vie sociale des masses indigentes de la population et de leur mécontentement pour le joug féodalo-bourgeois qui les suffoquait. L'importance de Migjeni comme prosateur a été fixée de la profondeur de son réalisme, qui représente une de ses réalisations les plus réussies, par l'ample ébauche sociale et par le psychologisme qui fait état de sa production de la période de maturité artistique.

Migjeni est mort à une époque où, comme le montrent ses productions, il grandissait comme un maître encore plus éminent de la prose sociale réaliste.

